Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Remzi Llumnica	**06.10.2023**	**10.10.2023**	**2023/0759**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **04.10.2023, OE "B & D ENGINEERING SH.P.K."- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me **nr: 2023/0759**, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku NUK është rekomanduar për kontratë OE "B & D ENGINEERING SH.P.K."- Prishtinë, apo **kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompes furnizuese ne bllokun A3" me nr. të prokurimit: "KEK-22-13147-5-2-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..**Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: **punë,** furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **400,000.00 €**.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0759 i dt:04.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

OPERATORI EKONOMIK - "B & D ENGINEERING SH.P.K."- Prishtinë,, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompes furnizuese ne bllokun A3" me nr. të prokurimit: "KEK-22-13147-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a atëherë OE "B & D ENGINEERING SH.P.K."- ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0759,:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3
Njoftimi për kontratë është bërë në datën 01.12.2022 ndërsa hapja publike është bërë në datën 12.01.2023.
Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë në datën 06.03.2023.
Me datë 07.03.2023 AK na ka dhënë qasje në dokumentacionin e procesit të prokurimit dhe tenderëve të OE konkurrent.
Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe bazuar në të gjeturat në tenderët e OE konkurrent, brenda afatit të rregullt kohorë me datë 13.03.2023 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.
AK me datë 20.03.2023 ka publikuar vendimin lidhur me shqyrtimin e kërkesës tonë ku sipas tije shihet se e ka refuzuar si të pabazuar.

Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullte kohorë, me datë 27.03.2023 iu kemi drejtuar OSHP-së me ankesë.

OSHP me datë 15.05.2023 ka nxjerrë vendim ku ankesën tonë e aprovon të bazuar dhe lëndën e kthen në rivlerësim.
AK pas rivlerësimit, me datë 12.09.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me anë të së cilit e kishte anuluar tenderin.
Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullte kohorë, me datë 16.09.2023 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.
AK me datë 25.09.2023 e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.
Hapja publike është bërë në datën 12.01.2023. Në procesin e hapjes publike nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë në datën 06.03.2023.

Me datë 07.03.2023 AK na ka dhënë qasje në dokumentacionin e procesit të prokurimit dhe tenderëve të OE konkurrent.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe bazuar në të gjeturat në tenderët e OE konkurrent, brenda afatit të rregullt kohorë me datë 13.03.2023 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.
AK me datë 20.03.2023 ka publikuar vendimin lidhur me shqyrtimin e kërkesës tonë ku sipas tije shihet se e ka refuzuar si të pabazuar.
Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullte kohorë, me datë 27.03.2023 iu kemi drejtuar OSHP-së me ankesë.
OSHP me datë 15.05.2023 ka nxjerrë vendim ku ankesën tonë e aprovon të bazuar dhe lëndën e kthen në rivlerësim.
AK pas rivlerësimit, me datë 12.09.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me anë të së cilit e kishte anuluar tenderin.
Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullte kohorë, me datë 16.09.2023 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 25.09.2023 e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues
AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së Nr. 04/L-042!
AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042!
AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042!
AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së Nr. 04/L-042!

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP nga OE "B & D ENGINEERING SH.P.K."- Prishtinë,.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet
Pretendimi 1.AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së me rastin e nxjerrjes së vendimit për anulimin e këtij tenderi dhe veçanërisht me arsyetimin e përdorur për anulimin e tij. Arsye pse mendojmë se AK e ka bërë këtë shkelje është sepse ka vepruar në kundërshtim të plotë me paragrafin 2 dhe 3 të LPP-së duke u sjellur në mënyrë shumë diskriminuese dhe shumë jo profesionale si dhe duke tejkaluar plotësisht kompetencat që i posedojnë me ligjin e prokurimit publik.
Veprimi që AK e ka ndërmarr dhe arsyetimi që AK e ka dhënë kur ka vendosur ta anuloj këtë procedurë të prokurimit nuk është në përputhje me asnjërën nga dispozitat ligjore të përcaktuara me LPP për mundësin e anulimit të tenderit dhe për mundësin e trajtimit të çështjes ashtu siç e ka bërë AK.

Përpos që nuk ka luajtur rol aktiv në shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë efikase dhe transparente, ka bërë tejkalim të komplet kompetencave të veta duke e luajtur rolin e avokatit të kompanisë nga e cila si duket ka interesa të ngushta materiale. Këtë më së miri e dëshmon fakti që Komisioni i Vlerësimit në mënyrë unanime e ka dhënë rekomandimin që ne të shpërblehemi me kontratë ndërsa Menaxheri i Departamentit për Punë e Shërbime dhe Drejtori i Prokurimit nuk e përkrahin këtë vendim të komisionit por në kundërshtim të plotë me LPP-në dhe me mundësit ligjore që ua jep ky ligj, e anulojnë tenderin duke konstatuar për gjoja shkelje të Kodit të Etikës. Si duket këta zyrtarë nuk ja kanë fare idenë se kur dhe ku duhet të aplikohet kodi i etikës andaj për qëllim të qartësimit të kësaj po e paraqesim mandatin e Kodit të Etikës në të cilin thirren zyrtarët në fjalë:

KODI ETIK I PROKURIMIT

Konform nenit 91.2 të Ligjit Nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 , Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik harton dhe nxjerr Kodin Etik, i cili duhet të respektohet nga të gjithë nëpunësit publik, shërbyesit civil dhe personat e tjerë të punësuar nga autoritetet kontraktuese.

"Kodi etik i prokurimit", i përket **Pjesës D** të rregullave të prokurimit publik. Përmban tre anekse të formularëve standard, si: **"Deklarata nën betim për Zyrtarët e Prokurimit", "Deklarata nën betim për anëtarët e komisionit për vlerësimin e tenderëve" dhe "Deklarata nën betim për punonjësit e KRPP-së, AQP-së dhe OSHP-së".**

Nga kjo po shihet hapur se ky kod i etikës nuk ka fare të bëjë me OE dhe me komunikimet mes tyre por pikërisht ka të bëjë me zyrtarë dhe të punësuar të AK-së dhe së nga ajo që thuhet në këtë kod, del që shkelësit e vetëm të këtij kodi janë pikërisht Menaxheri i DPSH-së dhe Drejtori i Prokurimit.

Këta dy të fundit shihet se kanë bërë tejkalim të kompetencave sepse konstatimin për shkelje apo jo të kodit të etikës nuk ka të drejt ta jep AK por është një institucion tjetër që e ka këtë përgjegjësi. Shto këtu faktin se edhe OSHP i ka pasur në trajtim të gjitha këta e- maila në të cilët thirren këta dy zyrtar dhe shumë qartë e ka dhënë vendimin e vet duke e sqaruar komplet situatën. Tani veprimi i këtyre dy zyrtarëve përpos që konsiderohet tejkalim i kompetencave, konsiderohet edhe mos respektim i vendimit të OSHP si institucioni më i lartë i prokurimit që vendos për shkeljet në procedurë dhe jep urdhrat për kthim të gjendjes në parametra normal.

Nisur nga krejt kjo po shihet se AK përkatësisht këta dy zyrtar të lartë të AK-së e kanë marrë në dorë edhe rolin e gjykatësit sepse me vërejtjen që e kanë konstatua në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së kanë thënë se gjoja ka pasur ndikim të drejtpërdrejt apo të tërthortë nga ana e Grupit" të OE "B&D Engineering SHPK & NOVAMAT" tek OE Sarmat LT s.r.o.. Lidhur me këtë AK ka konstatua gjithashtu se gjoja është shkelur Kodi i Etikës, por realisht janë pikërisht këta dy zyrtar që po e shkelin Kodin e Etikës me sjelljet e veta që hapur po dëshmojnë se kanë interesa nga OE që po e mbrojnë dhe njëherit po veprojnë jashtë kompetencave ligjore të përcaktuara për pozitat që ata mbajnë në AK. Veprimi i tillë konsiderohet shkelje e plotë e nenit 1 të LPP-së si dhe shkelje edhe e nenit 24 të LPP-së pikërisht nga Drejtori i Prokurimit prandaj kërkojmë nga OSHP që pas trajtimit të lëndës të merr masa ndëshkuese ndaj AK-së dhe drejtorit të Prokurimit. E-mailat që AK i konsideron ndikues i keni si të bashkangjitur kësaj kërkese.

Pretendimi 2. AK përkatësisht Menaxheri i DPSH-së dhe Drejtori i Prokurimit kanë shkelur nenin 7 të LPP-së me rastin e nxjerrjes së Njoftimit mbi Vendimin e AK-së sepse shihet hapur që janë duke vepruar në mënyrë diskriminuese ndaj neve dhe në të njëjtën kohë janë duke e përkrahur dhe favorizuar pa rezervë OE Sarmat LT s.r.o.. Bazuar në paragrafin 2 të këtij neni shihet se AK përkatësisht këta dy zyrtar kanë vepruar në kundërshtim të plotë me kërkesat e këtij paragrafi. Me sjelljen e tyre duke tejkaluar kompetencat e veta, duke luajtur rolin e gjykatësit, dhe duke u sjellur në mënyrë të papërgjegjshme sikur të ishin avokat të kompanisë Sarmat LT s.r.o., kanë nxjerrë një vendim për anulim të aktivitetit me arsyetimin e ndërhyrjeve

të drejtpërdrejta apo të tërthorta nga Grupi i OE "B&D Engineering SHPK & NOVAMAT tek OE Sarmat LT s.r.o., arsyetim i cili nuk përputhet me asnjërën nga mundësit e ofruar nga LPP dhe RRPP-001/2022.

Po që se AK apo edhe OE Sarmat Lt s.r.o. ka pasur dyshime apo mendime se ka pasur ndërhyrje dhe presion në këtë çështje, atëherë janë instancat tjera që duhet paraqitur rastin e jo të marrin drejtësinë në dorë dhe të gjykojnë thua se janë gjykatës. Konstatimi i AK-së përpos që është joprofesional, jo ligjor dhe jo real, është edhe tendencioz dhe injorues për faktin se bëhet nga persona jo kompetent dhe në kundërshtim me përshkimin e detyrave të punës që kanë.
Krejt kjo sjellje e këtyre dy personave e ka pru AK-në para një veprimi antiligjor ku hapur shihet favorizimi i OE Sarmat LT s.r.o. dhe në të njëjtën kohë shihet diskriminimi i Grupit të OE "B&D Engineering SHPK & NOVAMAT" si i vetmi tenderues i përgjegjshëm nga të gjithë konkurrentët prandaj konsiderohet me të drejt se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së.

<u>Pretendimi 4</u>. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht.

Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Edhe pse Komisioni i Vlerësimit me rastin e rivlerësimit kishte vepruar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit, me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat edhe të vendimit të OSHP-së, shihet se janë dy zyrtar nga AK dhe atë Menaxheri i DPSH-së si dhe Drejtori i Prokurimit të cilët nuk e aprovojnë raportin e komisionit vlerësues që në kundërshtim me mundësitë ligjore e procedurale, e anulojnë aktivitetin e prokurimit.
Ja si duket konstatimi i komisionit të vlerësimit: dhe i atyre që nuk e pranojnë mendimin e tyre:

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimi te ofertave konkurruese për aktivitetin e prokurimit: DEMONTIMI, MODERNIZIMI DHE INSTALIMI I POMPËS FURNIZUESE NE BLLOKUN A3 me numër. te prokurimit. KEKC-22-406-521, ka ardhur ne përfundim se ofertuesi Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe si e tillë është oferta qe ka ofruar çmimin me te lire të përgjegjshëm ne vlere prej 344,560.00 me TVSH.

Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit	**Nënshkrimi**	
MEHDI EJUPI		31.07.2023
ISMAIL GASHI		31.07.2023
HASAN MEXHUANI		01.08.2023

Ja si duket konstatimi i atyre që nuk e pranojnë mendimin e komisionit të vlerësimit:

Vërejtje përmbyllëse të Menagjerit DPSH lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:

Nuk pajtohem me propozimin nga komisioni i vlerësimit duke marrë parasysh emailin e datës 28.03.23 nga punëdhënësi i Samamat. Me këtë rast është shkelur Kodi i Etikës Prokurimit nenit 7.1 dhe kemi një ofertë me çmim më të lartë 44,560.01€.

u.d. Menagjere e Departamentit për punë dhe shërbime në KEK sha:
Emri dhe Mbiemri: Mirvete Gërguri
Nënshkrimi:
Data: 01.09.2023

Vërejtje përmbyllëse të Drejtorit të Prokurimit lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:

Pasi u bashkua me emailin datë 23.03.2023 dhe 24/03/2023 kemi shkelur e Kodit te etikës 7.2 dhe me këtë shkelje nëse do te bëjmë publikim e OB si ka ndodhur do te kemi çmimin me te lartë 44.560,01 € dyo 15%

u.d. Drejtori i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit në KEK sha:
Emri dhe Mbiemri: Ymer Dragusha
Nënshkrimi:
Data: 04/09/2023

Dhe ja si duket arsyetimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit:

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: **Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3**

Nr. i prokurimit	KEK-22-13147-5-2-1
Nr i brendshëm	KEKC-22-406-521

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës me TVSH
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o, Agim Ramadani, Relax OB-N, Hyrja 2-K-2, Nr.A Prishtine, 10000, Prishtine	299.999.99
2.	Flamtron, K.P.Krešimira IV br:1, 44320, Kutina	363.440.00
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, LIDHJA E PEJES 69, -10000, PRISHTINË	344.560.00

Rezultati i aktivitetit te prokurimit: KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. e anulon aktivitetin e prokurimit.
Ne aktivitetit ne prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 dy OE kane autorizimin nga i njëjti OE-FLOWSERVE dhe kane ofertuar si ne vijim Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o me çmim te ofertës 299.999.99 € dhe B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k me çmim te ofertës 344.560.00 €
Gjate fazës se vlerësimit kemi pranuar emalin me datën 23.03.2023 dhe 24.03.2023 nga anëtari i Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë& SARMAT LT , s.r.o, ku pas presionit te bere nga autorizuesi OE-FLOWSERVE për OE SARMAT LT , s.r.o i njeti është tërhequr nga Aktiviteti i prokurimit Riparimin e pompës furnizuese ne bllokun A3,
Nga komunikimet e pranuara vërehet qartë ndërhyrja e anëtarit te konzorciumit NOVOMAT qe te mos i mundësohet dhënia e kontratës grupit te OE Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë& SARMAT LT , s.r.o.
Bazuar ne komunikimet e pranuara ZPP nuk e kam aprovuar rekomandimin e komisionit te rivlerësimit për shkak te ndikimit ne mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ne këtë aktivitet te prokurimit nga grupi i OE B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT , ku qëllimi i këtij OE ka qene te pranohet oferta tij
Duke u bazuar ne përgjegjësit dhe autorizimet qe parashihen për Zyrtarin përgjegjës te prokurimit ne legjislacionin e prokurimit ne fuqi është marr vendim qe ky Aktivitet i prokurimit te anulohet .

Me respekt,

Zyra Ekzekutive e Prokurimit KEK – sh.a.

12/09/2023

E gjithë kjo sjellje e Menaxherit të DPSH-së dhe Drejtorit të Prokurimit nuk ka fare të bëjë me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në kuadër të pozitave që mbajnë.
Fillimisht ata thirren gabimisht në Kodin e Etikës i cili nuk e ka fare mandatin të trajtoj çështjen të cilën AK e përdor si shkas për ta anuluar aktivitetin e prokurimit. Së dyti, arsyetimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk përkon me asnjërën nga dispozitat ligjore që flasin për vlerësimin e tenderëve dhe as atyre për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Dispozitat ligjore dhe detyrat e zyrtarëve në fjalë janë të merren vetëm me atë se a ka vlersuar komisioni i vlerësimit konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe konform kërkesave ligjore e jo të merren me atë se kush kujt i ka shkruar e-mail.
Çështjen e përgjegjshmërisë e ka trajtuar shumë saktë OSHP me vendimin e datës 15.05.2023 andaj nuk kemi se pse të merremi më shumë me këtë çështje.

OE Sarmat LT s.r.o. bashkë me anëtarin tjetër të grupit ishin të papërgjegjshëm sepse nuk posedonin autorizimin adekuat nga prodhuesi.
Ata kishin paraqitur një autorizim jo të saktë duke tentuar ta vënë në lajthitje AK-në (që si duket ja kanë dal) por pas reagimit tonë, u zbulua se ata nuk kanë autorizim valid dhe si të tillë është dashur vet AK të i konsideroj me kohë si të papërgjegjshëm. Pavarësisht kësaj ndërhyrja e OSHP-së dhe sjellja e drejtësisë në vend duke e aprovuar ankesën tonë si të bazuar ishte mëse e mjaftueshme për AK-në që ta mbyllë aktivitetin e prokurimit me shpalljen fitues të Grupit të OE "B&D Engineering SHPK & NOVAMAT". AK nuk e respektoi vendimin e OSHP-së dhe pa asnjë bazë ligjore u thirr në detaje që janë jashtë kompetencave të sajë. Përpos kësaj, AK aplikoi edhe dispozita e kode që nuk e mbulojnë fare fushën e tillë. AK realisht nuk ka pasur të drejtë fare të veproj kështu sepse sipas komunikimeve po kuptohet se këtu kemi të bëjmë edhe me një konflikt të interesit që janë të përfshirë disa zyrtarë të AK-së. Për korrektësi duam të sqarojmë se sipas letrës së Sarmat Lt s.r.o. kuptohet se AK ishte në vizitë tek ky OE para se të shpallej ky tender andaj kjo duket paksa edhe e orkestruar nga ane e AK-së dhe e këtij grupi të OE.
Vet fakti që disa zyrtar të AK-së po tentojnë me çdo kusht që ta shpërblejnë me kontratë këtë Grup të OE madje edhe duke shkelur ligje e duke vepruar në kundërshtim me kompetencat e veta, tregon se këta të fundit dyshohen se kanë ndonjë interes personal nga grupi i OE në fjalë.

Konstatimi i AK se gjoja kemi ndërhyrë apo bërë presion ndaj OE Sarlmat LT s.r.o., në bazë të komunikimeve që i keni në attach nuk mundet të vërehet askund se ka ndodhur diçka e tillë. Arsyeja pse i kemi mbrojtur interesat e kompanisë tonë si kompania e vetme e autorizuar nga prodhuesi FLOWSERVE, nuk nënkupton presion por mbrojtje e drejtë dhe e ligjshme e interesave tona. Po të sillej AK si duhet këtë çështje që e ka sqaruar shumë mirë OSHP dhe ku decidivisht e ka konstatua se OE Sarmat LT.s.r.o. nuk ka autorizim valid për këtë tender, do duhej ta mbyllte me kohë duke na shpallur neve fitues.
Edhe arsyetimi tjetër se gjoja çmimi jonë është më i lartë nuk përkon fare me nenin 59 të LPP-së e as me kriterin e vlerësimit të tenderëve të përcaktuar na vet AK. Vet fakti që OE fillimisht duhet plotësuar të gjitha kushtet për tu cilësuar të përgjegjshëm e mandej të krahasohen çmimet, tregon se OE Sarmat LT s.r.o. bashkë me grupin nuk ishin të përgjegjshëm andaj arsyetimi i AK-së për çmimin aq sa është jo profesional, është edhe naiv.

Kompanitë jo profesionale që nuk posedojnë aftësitë teknik e profesionale të duhur është e ditur që ofertojnë me çmime të ulëta po ja që kushtet ligjore dhe kriteret e dosjes së tenderit e përcaktojnë rregullin e të qenurit edhe i përgjegjshëm përpos posedimit të çmimit më të ulët. Nisur nga kjo del që Grupi i vetëm i OE që ishte i përgjegjshëm në këtë tender jemi ne, andaj AK është dashur dhe duhet të na shpallte neve si fitues.

Për korrektësi dhe me të vetmin qëllim sqarimin e këtij kontesti të pa arsyeshëm, po e pasqyrojmë deklarimin e prodhuesit FLOWSERVE lidhur me autorizimin, po e pasqyrojmë atë që ka konstatua OSHP si dhe letrën që ne i kemi shkruar OE Sarmat LT s.r.o. Këtë po e bëjmë me të vetmin qëllim që të konstatohet se është vet AK që është dashur ta eliminoj me kohë këtë OE si dhe të shihet se nuk ka asnjë presion dhe ndërhyrje që ta ketë dëmtuar procesin.
OE në fjalë, edhe po të përsëritet ky aktivitet i prokurimit, nuk ka mundësi teknike e dokumentare ta fitoj si projekt sepse teknikisht nuk mundet me realizuar projektin e tillë pasi që i mungon autorizimi i prodhuesit të artikujve që do të riparohen.

Ja si duket deklarata e FLOWSERVE:

FLOWSERVE

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.
Rr. Nënë Tereza, 36
Prishtinë
10 000

Brussels March 10, 2023

Reference: Procurement Number: **KEK-22-13147-5-2-1**
Internal Number: **KEKC-22-406-521**
Title: "Dismantling, Modernization and Installation of Feeding Pump in block A3"
"Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3"

To attention of: Mr. Nagip Krasniqi, Mr. Ymer Dragusha, Mr. Emin Tmava, Mrs. Mirvete Gerguri

Dear Mr. Nagip Krasniqi,
Dear Lady and Gentlemen,

With reference to the above-mentioned tender, we would like to let you know following information:

1- Flowserve has appointed 1 distributor for your account, namely the company **Novamat sh.p.k**, located in: Rruga "Ismail Qemali", Pallati Samos Tower, Kati i 8të, Nr. 41, Tirana, ALBANIA, and we authorized this distributor to participate in our name to the above-mentioned tender, only.

2-The company **Novamat sh.p.k** has a valid distributor agreement covering the products of the above mentioned tender.

3-Flowserve does NOT authorize the company Sarmat LT s.r.o. to participate in the name of Flowserve, nor using any Flowserve logo, letter or certificates, in tenders outside of their agreed territory (Slovakia)

4-The certificate (memorandum), a Flowserve salesperson issued on Friday January 4, 2010, has no validity and needs to be seen as void

Flowserve and his official local distributor Novamat are ready to clarify the situation in case needed.

Please feel free to reach out to me,

Best regards

Jos Wilmaerts
Director Distribution Sales EMA
Jwilmaerts@Flowserve.com
Mobile +32 473 925 610

Pra nga kjo po shihet se AK është dashur me kohë ta eliminoj nga konkurrenca këtë OE dhe se i njëjti nuk ka asnjë mundësi teknike të realizoj projektin e tillë.
E themi këtë sepse riparimi do bëhet në punëtoritë e FLOWSERVE dhe të drejtën për ta dërguar pompën dhe materialet tjera tek FLOWSERVE e kemi ekskluzivisht vetëm ne. Ja si duket konstatimi i OSHP-së për çështjen e autorizimit që ka parapri krejt këtij kontesti:

Po ashtu Eksperti Shqyrtues përmes raportit të ekspertizës sqaron se Kompania SARMAT ka një memorandum me Flowserve që daton në vitin 2010 për pompa të tjera dhe atë vetëm për territorin e Sllovakisë por jo për modelin e pompës e cila kërkohet në këtë proces të prokurimit e që e prodhon HALBERG. Me që tek ky memorandum nuk ekziston lloji i pompës që tani ky grup i OE e ka ofertuar, njoftojmë se FLOWSERVE e ka marr në zotësi prodhuesin HALBERG në vitin 2015, që tregon edhe më shumë se memorandumi i tillë nuk ka asnjë vlerë reale për tu pranuar nga AK si i rregullt (dëshmia për kohën e kalimit të HALBERG në pronësi të FLOWSERVE gjendet tek ëeb faqja www.halberg.com/cms/index.php?id=1570 Me dorëzimin e një dokumenti të pavlefshëm, ligjërisht të pa lejuar për aplikim në territorin ku zhvillohet procedura tenderike, ky grup i OE është i papërgjegjshëm dhe si i tillë nuk do duhej kurrsesi të kualifikohej si një ofertues i përgjegjshëm prandaj AK ka tejkaluar kompetencat duke mos i marrë për bazë informacionet lidhur me ketë dokument i cili ka ndikuar në kualifikim të OE SARMAT ndërsa ka ndikuar në rezultatin e OE B & D ENGINEERING SH.P.K. për diskualifikim kurse AK ne përgjigjen për Kërkesën për rishqyrtim kishte deklaruar lidhur me shkresën për tërheqjen e autorizimit të prodhuesit FLOWSERVE te kishin pranuar me 11.03.2023 për anëtarin e konsorciumit te grupit të operatorëve ekonomik të shpallur fitues SMART LT s.r.o. duke *pohuar me tej se komisioni i vlerësimit kishte përfunduar vlerësimin dhe i njëjti ishte dërguar për publikim me 06.03.2023 kurse dokumentacioni për prodhuesin atëherë ka qenë valid sepse nuk ka qenë e përkufizuar afati i skadimit po ashtu vet kompania e autorizuar ka qenë pjesë e grupit të formuar për konkurim për këtë aktivitet kurse deklarojnë po ashtu se nuk kishin pranuar ne forme zyrtare ndonjë dokument të till.* Prandaj Paneli Shqyrtues vendosi për ta kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit në fjalë. Meqë Kompania "SARMAT" nuk është distributor i FLOWSERVE dhe nuk ka të drejtë për të autorizuar një palë tjetër në emër të FLOWSERVE pa autorizimin e tyre, atëherë ka bërë përdorimin e pa autorizuar të ISO Certifikatave të prodhuesit FLOWSERVE, le të vërtetohet saktë edhe ky pohim i ankuesit sipas dokumentacioneve të ofruara nga i grupi i të rekomanduarve. Po ashtu AK të vërtetoj faktin nëse të gjith anëtarët e konsorciumit të rekomanduar qëndrojnë prapa marrëveshjes së tyre për të ofertuar në këtë projekt.

Përveç kësaj mund të thuhet se AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat dhe ligjet e prokurimit publik ngase konstatohet se OE "B & D ENGINEERING SH.P.K." ka kontaktuar prodhuesin FLOWSERVE dhe e ka njoftuar me rastin, të cilët kanë reaguar menjëherë përmes përfaqësuesit ligjor të tyre që e mbulon territorin e Evropës. Këta të fundit kanë reaguar duke lëshuar një deklaratë me të cilën e kanë njoftuar edhe KEK-un dhe udhëheqësit kryesor të tyre duke treguar se kompania SARMAT nuk është distributor i prodhimeve të tyre për këtë tender dhe se thirrja në autorizimin e viti 2010 është e jashtë ligjshme. Andaj, Paneli Shqyrtues bazuar në të dhënat e lartcekura vie në përfundimin se në këtë aktivitet të prokurimit AK nuk ka respektuar drejtë dispozitat ligjore dhe vendosi ta kthej në rivlerësim në mënyrë që AK ta bëjë trajtimin e barabartë të gjithë OE, të bëj kontrollimin dhe vlerësimin e dokumentacionit në mënyrë të drejtë, të respektoj kërkesat që vet AK ka vendosur në DT dhe në njoftimin në kontratë

Edhe nga kjo shihet se OSHP i ka pasur në posedim të gjitha komunikimet dhe po të kishte ndonjë presion apo ndërhyrje siç pretendon AK-ja, sigurisht do ta trajtonte si çështje. OSHP shumë qartë e ka konstatua se OE Sarmat LT s.r.o. nuk ka autorizim dhe si i tillë duhet trajtuar sipas dispozitave ligjore dhe kërkesave të dosjes së tenderit. Ja si duket edhe shkresa që ne i kemi dërguar OE Sarmat LT s.r.o.:

Dear Mr. Jos Wilmaerts & Flowserve Team,

Following our correspondence for this tender procedure of KEK, please let us kindly inform you as follows:
- Regarding the complaint letter that we have submitted to KEK, the end user came up with a decision. They have refused our letter.

The reason why this letter has been refused by KEK is the fact that KEK does not accept the response that Flowserve has been submitting to them regarding this matter of "SARMAT Authorization letter". Attached in the word document it is translated in English language the main paragraph of this letter received from KEK for your information.

- As it can be understood from this letter, again we come to the same point that we have been discussing so far: SARMAT has been participating in this tender procedure directly, as part of a consortium. And for this reason KEK can not consider this Authorization letter as not valid, even though it is specifically written in that letter that the territory of Slovakia is the one where Sarmat can apply such a letter, but he has participated directly in the tender!! And this is the second time that a such a deception occurs from Sarmat together with Klaus Union.
-

@ Dear Gentlemen of Sarmat,
As you can probably understand, this entire situation created is unprofessional, uncooperative, but above all it is illegal and strictly forbidden to be applied in business nowadays & forbidden according to FLOWSERVE rules & policy!!

What you have done is not at all correct and your involvement with Klaus Union in this cooperation results completely in contradiction with every, law, every rule and policy of doing business.
What is needed by you is to issue a written statement addressed to KEK through which you inform the final client that the authorization letter submitted by you during the bidding phase is not amenable to this procedure, that it is an invalid and non-applicable document outside Slovakia territory.

Otherwise, from our side, we will have to take all the necessary legal steps, in accordance with the public procurement law; International business laws & Code of Criminal Procedures in the Republic of Kosovo.
Such unprofessional and damaging actions are totally unacceptable and impermissible even for other parties involved in this tendering process, such as our company, which has been operating in the market for so many years, strictly respecting all the rules, laws and obligations arising from them & also at the same time by respecting all the strict rules & company policies of FLOWSERVE.

It is now a proven fact that you, together with Klaus Union, have been cooperating together since July 2022 and you have been preparing this procurement procedure long before the tender was announced in the system, in complete contradiction to the Public Procurement laws.

Dear Gentlemen of Sarmat, through your actions and inactions, you have damaged all the FLOWSERVE group including also all the distributors by taking over your activity in a territory that is not under your responsibility.

At the end we do have one question: Let's assume that your consortium is being awarded with a contract & you will have to implement such a project. The main question is:

Where are you planning to do the modernization of the pump? How have you foreseen this project implementation?

We definitely need to have a feedback from @ SARMAT & from @ FLOWSERVE if possible too!

It is very important that SRAMAT takes all the responsibilities and at the end to react in a professional way and in respect to all of the evolved parties in this unpleasant situation.

Thank you & Best Regards,

on Behalf of Mr. Mehmet KRASNIQI,

Nga krejt kjo letër po shihet hapur se askund dhe në asnjë formë shkrimi i tillë nuk mund të konsiderohet si ndërhyrje apo presion ndaj OE Sarmat LT s.r.o. por vetëm njoftim dhe sqarim, por si duket ky OE nuk e ka kuptuar veprimin e vet që e ka bërë. Këtë e ka sqaruar shumë mirë edhe prodhuesi FLOWSERVE andaj nuk ka asnjë logjikë të merret si presion.

Edhe nëse ky OE mendon ashtu, atëherë janë organet e drejtësisë që e trajtojnë këtë çështje e jo AK të merr në rolin e gjykatësit, avokatit, dhe aplikuesit të paligjshëm të ligjeve dhe dispozitave krejtësisht të gabueshme për ta trajtuar çështjen gjoja si shkelje të Kodit Etik.

Nga krejt kjo që u sqarua më sipër po shihet se AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP-së por ka vepruar në kundërshtim të plotë edhe me Kodin e Etikës duke

tejkaluar kompetencat e veta, që sipas nenit 414 të KPRK-së konsiderohet edhe vepër penale. Po ashtu edhe sjellja e OE Sarmat LT s.r.o. që kishte paraqitur dëshmi të rrejshme edhe pse kishte nënshkruar deklaratën nën betim, konsiderohet shkelje e rëndë që sipas nenit 415 të KPRK-së konsiderohet vepër penale.
Në këtë rast ne kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të ndërmerr masat disiplinore të përcaktuara me ligj ndaj atyre që kanë vepruar në kundërshtim me LPP-në dhe ndaj atyre që kanë ofruar dëshmi të rrejshme.

Krejt kjo që u tha më lartë tregon se AK (përjashto komisionin e vlerësimit) ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së.

<u>Pretendimi 5.</u>AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-001/2022 me rastin e anulimit të tenderit dhe shkelja e tillë vjen si pasojë e mos respektimit të nenit 1, 7 dhe 59 të LPP-së si dhe mos respektimi e vendimit të OSHP-së. Po që se do respektoheshin si duhet kriteret e dosjes së tenderit dhe vlerësimi do bëhej në përputhje me nenet e cekura më lartë, AK do kishte në mesin e tenderuesve një Grup të OE që i plotëson të gjitha kriteret e dosjes së tenderi dhe që posedon edhe çmimin më të ulët në krahasim me të gjithë tenderuesit konkurrues të përgjegjshëm, kështu që nuk do ishte fare e nevojshme për ta anuluar tenderin. Pas analizimit dhe verifikimit të ofertave të të gjithë OE konkurrent në këtë tender, shihet se të gjithë të tjerët ishin të papërgjegjshëm dhe se tenderi i vetëm që i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga AK dhe që është plotësisht i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, është Grupi i OE "B&D Engineering SHPK & NOVAMAT". Nisur nga kjo lirisht mund të konstatohet se aplikimi i anulimit të tenderit është bërë qëllimisht për të mos na e dhënë neve këtë tender.

Arsyetimi i anulimit të tenderit që AK e ka publikuar duket kështu:

> Rezultati i aktivitetit te prokurimit: KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. e anulon aktivitetin e prokurimit.
> Ne aktivitetit ne prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 dy OE kane autorizimin nga i njëjti OE-FLOWSERVE dhe kane ofertuar si ne vijim Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o me çmim te ofertës 299.999.99 € dhe B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k me çmim te ofertës 344.560.00 €
> Gjate fazës se vlerësimit kemi pranuar emalin me datën 23.03.2023 dhe 24.03.2023 nga anëtari i Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë& SARMAT LT , s.r.o, ku pas presionit te bere nga autorizuesi OE-FLOWSERVE për OE SARMAT LT , s.r.o i nijeti është tërhequr nga Aktiviteti i prokurimit Riparimin e pompës furnizuese ne bllokun A3,
> Nga komunikimet e pranuara vërehet qartë ndërhyrja e anëtarit te konzorciumit NOVOMAT qe te mos i mundësohet dhënia e kontratës grupit te OE Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë& SARMAT LT , s.r.o.
> Bazuar ne komunikimet e pranuara ZPP nuk e kam aprovuar rekomandimin e komisionit te rivlerësimit për shkak te ndikimit ne mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ne ketë aktivitet te prokurimit nga grupi i OE B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT , ku qëllimi i këtij OE ka qene te pranohet oferta tij
> Duke u bazuar ne përgjegjësit dhe autorizimet qe parashihen për Zyrtarin përgjegjës te prokurimit ne legjislacionin e prokurimit ne fuqi është marr vendim qe ky Aktivitet i prokurimit te anulohet .

Ndërsa deklarata e komisionit të vlerësimit, e Menaxherit të DPSH-së dhe Drejtorit të Prokurimit tek procesverbali i vlerësimit duket kështu:

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimi te ofertave konkurruese për aktivitetin e prokurimit: DEMONTIMI, MODERNIZIMI DHE INSTALIMI I POMPËS FURNIZUESE NE BLLOKUN A3 me numër. te prokurimit. KEKC-22-406-521, ka ardhur ne përfundim se ofertuesi Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe si e tillë është oferta qe ka ofruar çmimin me te lire të përgjegjshëm ne vlere prej 344,560.00 me TVSH.

Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit	Nënshkrimi	
MEHDI EJUPI		31.07.2023
ISMAIL GASHI		31.07.2023
HASAN MEXHUANI		01.08.2023

Vërejtje përmbyllëse të Menagjerit DPSH lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:

Nuk pajtohem me propozimin nga komisioni i vlerësimit duke marrë parasysh emailin e datës 28.03.23 nga përfaqësuesi i Samamat. Me këtë rast është shkelur Kodi i Etikës Prokurimit neni 7.2 dhe kemi një oferte me çmim me të lartë 44,560.01€.

u.d. Menagjere e Departamentit për punë dhe shërbime në KEK sha:

Emri dhe Mbiemri: Mirvete Gërguri

Nënshkrimi:

Data: 01.09.2023

Vërejtje përmbyllëse të Drejtorit të Prokurimit lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në emailin datë 23.03.2023 dhe 24/03/2023 kemi shkelur Kodit te etikës 7.2 dhe me këtë shkelje nëse do të bëjmë publikim e OE qe ka ndërhyrë do te kemi çmimin me te larte 44.560,01 € apo 15%

u.d. Drejtori i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit në KEK sha:

Emri dhe Mbiemri: Ymer Dragusha

Nënshkrimi:

Data: 04/09/2023

Ky arsyetim nuk përputhet me asnjë nga mundësitë që i ofron neni 62 i LPP-së dhe neni 43 i RRPP-001/2022 për anulimin e aktivitetit të prokurimit.
Duhet ceket edhe kjo se asnjeri nga Legjislacioni Primar / as Sekondar që ishte në fuqi kur ka filluar procesi i prokurimit e që duhet aplikohet deri në mbyllje të këtij aktiviteti nuk ofron mundësi të anulimit të tenderit për arsyetimin e tillë. Aq më pak kur dihet se komisioni i vlerësimit e ka dhënë rekomandimin që ne të shpallemi fitues. Arsyetimi nga AK përkatësisht i Menaxherit të DPSH-së dhe Drejtorit të Prokurimit nuk përputhen me asnjërën nga mundësitë ligjore të LPP-së dhe RRPP-001/2022.

Ja si duken mundësitë që i ofron LPP dhe RRPP-001/2022 për ndërprerje të aktivitetit të prokurimit pas hapjes publike:

Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

   1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

   2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

Ndërsa sipas RRPP-së përkatësisht nenit 43, mundësitë për anulim duken kështu:

43.5 Procedura e prokurimit *pas hapjes së ofertave* duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i paripërueshëm; ose
k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i paripërueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

43.7 Procedura e prokurimit ***pas hapjes së ofertave* mund** të anulohet për arsyen e mëposhtme:

a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Arsyetimi i AK-së përpos që nuk është i saktë dhe nuk është i vërtetë, është jashtë kompetencave të tijë dhe nuk përputhet me asnjërën nga dispozitat ligjore që e mundësojnë anulimin e aktivitetit të prokurimit pas hapjes publike.

Nisur nga kjo nuk kemi se si të mendojmë ndryshe për pos asaj që AK po shkelë qëllimisht nenin 62 të LPP dhe neni 43 të RRPP-001/2022, me të vetmin qëllim që të mos na japë neve kontratën në fjalë.

AK ka shkelur edhe nenin 108/A të LPP-së me rastin e shqyrtimit të pretendimeve tona sepse edhe në përgjigjen e dhënë prap shihet se nuk ka vepruar në përputhje me LPP-në.

Edhe tek përgjigjja e tillë vërehet tejkalimi i kompetencave nga Drejtori i Prokurimit andaj me të drejt kërkojmë nga OSHP që të merr masa ndaj këtij zyrtari për mos respektim të LPP-së dhe detyrave të veta të përcaktuara me ligj.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që thamë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar ankesa e Grupi i OE "B&D Engineering" & "NOVAMAT SH.P.K." lidhur me tenderin "Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3" i iniciuar nga KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së dhe në kërkesat e dosjes së tenderit e që realisht më pas do duhej që FITUES të shpallej Grupi i OE "B&D Engineering" & "NOVAMAT SH.P.K."

Dëmet materiale

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim dhe kontratë.

Reagim i Grupi i OE "B&D Engineering" & "NOVAMAT SH.P.K."

B&D Engineering

NOVAMAT
Quality and Safety from one source

REAGIM

Data: 12.09.2023

Ne emer te konzorciumit: **B&D Engineering Sh.P.K & NOVAMAT Shpk.**

Titulli I projektit: **"Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3"**

Nr i prokurimit: **KEK-22-13147-5-2-1**/Nr i brendshëm: **KEKC-22-406-521**

I nderuar,

Fillimisht dua të ju njoftoj se vendimi dhe shënimi që ju e keni ofruar përmes formularit B58 është në kundërshtim të plotë me mundësitë që i ofron dhe i lejon neni 62 i LPP-së dhe neni 43 i RRPP-së.

Përpos kësaj shihet se AK ka tejkaluar plotësisht kompetencat e veta për çka është i thirrur dhe se shihet hapur se është duke e luajtur rolin e avokatit për kompaninë Sarmat d.o.o. që si veprim është në kundërshti të plotë me normat ligjore, procedurale, administrativ e çka është më e keçja është në kundërshtim me normat profesionale të Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit. Realisht kompania nuk ka pasur si dhe nuk ka mundur të tërhiqet nga gara sepse një OE i papërgjegjshëm siç ishte kjo kompani do ishte dashur të eliminohej nga vet AK-ja. Me që AK nuk e ka bërë këtë duke tentuar që kundërligjshëm ta shpallë si fitues, atëherë neve na është dashur që ne të parashtrojmë ankesë dhe është OSHP-ja ajo që e ka pastruar këtë situatë të cilën AK po e keqpërdor shumë. Si duket dikush brenda zyrës së prokurimit ka edhe interesa materiale dhe personale të ngushta nga kjo kompani me që në mënyrë arbitrare dhe të kundërligjshme po tenton ta mbrojë edhe duke tejkaluar kompetencat e veta. Se a ka pas ndërhyrje apo jo nuk është AK-ja ajo që mundet me gjykua andaj këtë çështje AK ka mundur ta drejtor te organet kompetente e jo ta merr vet rolin e gjykatësit.

B&D Engineering

NOVAMAT
Quality and Safety from one source

Ne do të jemi shumë të kujdesshëm që lëndën në fjalë ta trajtojmë në mënyrë sa më ligjore duke e drejtuar rastin për hetim tek organet kompetente dhe duke kërkuar edhe rishikim të vendimit përmes kërkesës për rishqyrtim apo eventualisht edhe përmes ankesës në OSHP.

Me keqardhje e themi se AK e ka humbur komplet integritetin dhe profesionalizmin e sajë duke rënë pre e interesave të caktuara në dëm të respektimit të ligjit dhe rregullave për të i trajtuar OE si të barabartë. E themi këtë sepse po shihet hapur se neve po na diskriminon në mënyrën më të ulët të mundshme ndërsa OE Sarmat d.o.o. po e favorizon me çdo kusht. Deklarimin se ne kemi bërë ndërhyrje në proces, ne e konsiderojmë si shpifje me qëllim dëmtimin e reputacionit tonë mirëpo edhe për këtë do të kujdesemi që përmes zyrës tonë ligjore të ngritim padi ndaj zyrtarit në fjalë dhe pse jo edhe ndaj AK-së për këtë vepër sa të ulët aq edhe të kundërligjshme.

Mbetemi shumë të zhgënjyer me veprimi tuaj, por shpresojmë se kjo informatë do të ju bëjë të mendoni pak për veprimin tuaj të paligjshëm që e keni marrur dhe konsekuencat e tij ku sipas KPRK-së konsiderohet vepër e pastër penale.

B&D Engineering Sh.P.K.

Per: Novamat Sh.P.K.

Përgjigje dhe dokumentacioni percjellës sa i përket kërkeses për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit nga Grupi i OE "B&D Engineering" & "NOVAMAT SH.P.K - Vendimi mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim nga AK-ja.

1. Vendimi i AK-se lidhur me rishqyrtimin e anlkeses nga OE ankues Grupi i OE "B&D Engineering" & "NOVAMAT SH.P.K."

KEK KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a. KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Data 25.09.2023

PËR OPERATORIN EKONOMIK	B & D ENGINEERING SH.P.K. rr. Nena Terezë nr.4, 12000 Fushë Kosovë
NGA	KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Zyra Ekzekutive e Prokurimit, rr. Nëna Terezë nr. 36 10000 Prishtinë. Ymer Dragusha, u.d. Drejtor i zyrës ekzekutive të Prokurimit
NUMRI I KËRKESËS PËR RISHQYRTIM	ELEKTRONIKE
DATA E PARASHTRIMIT TË KËRKESËS	16.09.2023
SHQYTIMI I ANKESËS TË PARASHTRUAR	☒ pas njoftimit të AK mbi anulimin e aktivtetit
TITULLI I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT	Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3
NR. I PROKURIMIT:	KEK-22-13147-5-2-1
NR I BRENDSHËM	KEKC-22-406-521
DATA E PUBLIKIMIT	01.12.2022
DATA E PRANIMIT TË TENDERËVE	21.12.2022

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit në bazë të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas kërkesës të parashtruar për rishqyrtim nga Operatori Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 me numër prokurimit KEKC-22-406-521, Autoriteti Kontraktues mori këtë:

Vendim

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paraqitur për rishqyrtim nga Operatori Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 me numër prokurimit KEKC-22-406-521

Arsyetim

Me datën 16.09.2023, Autoriteti Kontraktues KEK. sha ka pranuar kërkesën për rishqyrtim nga B & D ENGINEERING SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 me numër prokurimit KEKC-22-406-521

Konform nenit 108/A, të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, pas ekzaminimit të Dosjes së tenderit dhe shqyrtimit të rrjedhjes së procedurës së tenderimit, Autoritetit Kontraktues në bazë të kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik sqaron me sa vijon:

ANALIZË DHE SQARIM

Ne kemi pranuar Kërkesë për rishqyrtim për aktivitetit te prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 me numër prokurimit KEKC-22-406-521, ku ju pretendoni se dispozitat e LPP-së janë shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Për informatën tuaj bazuar ne pretendimin e juaj ankimor dhënë ne kërkesën për rishqyrtim ju japim ne vazhdim përgjigje në bazë të pikave ankimore të juaj.

Pretendimi i juaj se Dispozitat ligjore ne vijim janë shkelura nga Autoriteti Kontraktues, nuk qëndron dhe ju japim përgjigje.

Ne aktivitetit ne prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 bazuar ne Vendimin e panelit të OSHP-së me numër 2023/0166 e kthen në rivlerësim.
Autoriteti Kontraktues menjëherë ka caktuar komisionin për rivlerësim dhe me datën 01.08.2023 e nënshkruajnë raportin e vlerësimit dhe e dorëzojnë te kompletuar me rekomandim për ZPP me datën 21.08.2023.
Rekomandimin e komisionit te rivlerësimit se pari e ka refuzuar Menaxherja e departamentit për pune dhe shërbime duke dhënë sqarime dhe është dorëzuar tek ZPP me komente.
Pas rishikimit edhe njëherë të dokumenteve gjatë zhvillimit te këtij aktiviteti te prokurimit qe nga publikimi dhe vlerësimi i ofertave e deri tek dorëzimi i dokumenteve pas rivlerësimit ku ne kete aktivtet te prokurimit kemi dy OE që kane autorizimin nga i njëjti OE-FLOWSERVE dhe kane ofertuar si ne vijim Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o me çmim te ofertës 299.999.99 € dhe B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k me çmim te ofertës 344.560.00 €
Gjate fazës se vlerësimit kemi pranuar emalin me datën 23.03.2023 dhe 24.03.2023 nga anëtari i Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega ne Kosovë& SARMAT LT , s.r.o, ku pas presionit te bere nga autorizuesi OE-FLOWSERVE për OE SARMAT LT , s.r.o ku ky anëtar i grupit është tërhequr nga grupi i operatoreve ekonomik me çmimin me te ulet për këtë aktivitet të prokurimit Riparimin e pompës furnizuese ne bllokun A3.
Nga komunikimet e pranuara vërehet qartë ndërhyrja e kompanisë NOVOMAT shpk që është anëtar i grupit te konzorciumit që ka parashtruar këtë kërkese për rishqyrtim qe te mos i mundësohet dhënia e kontratës grupit te OE Klaus Union CZ AS Dega ne Kosovë& SARMAT LT , s.r.o.
E gjithë ndërhyrja ka qene pas publikimit te Vendimit te Autoritetit Kontraktues mbi vendimin e saj qe te shpërblehet me kontrate grup i operatoreve ekonomik Klaus Union CZ AS Dega ne Kosovë; SARMAT LT , s.r.o me çmim te ofertës 299.999.99 €.
Bazuar ne komunikimet e pranuara ZPP nuk e kam aprovuar rekomandimin e komisionit te rivlerësimit për shkak te ndikimit ne mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ne këtë aktivitet te prokurimit nga grupi i OE B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT , ku qëllimi i këtij OE ka qene te pranohet oferta tij me vlerën me te lartë nga grup i operatorit ekonomik qe ne hapjen e ofertave ka qene me çmimin me te ulet për këtë aktivitet te prokurimit

Duke u bazuar ne përgjegjësit dhe autorizimet qe parashihen për Zyrtarin përgjegjës te prokurimit ne legjislacionin e prokurimit ne fuqi është marr vendim qe ky Aktivitet i prokurimit te anulohet.

Bashkangjitur përgjegjës ndaj kërkesës për rishqyrtim i gjeni komunikimet e zhvilluar dhe ardhje e vendimit për tërheqjen e anëtari te te konzorciumit nga formimi i grupit.

REKOMANDIMI I ZYRËS EKZEKUTIVE TË PROKURIMIT

- Bazuar në sqarimet e dhëna më lart për aktivitetin e prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 me numër prokurimit KEKC-22-406-521 konstaton se Kërkesa për rishqyrtim është **e pa bazuar.**
- Rekomandon që kërkesa për rishqyrtim e Operatori Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K, të **refuzohet si e pabazuar.**

KONKLUZIONI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ankesën e B & D ENGINEERING SH.P.K, i cili është i pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues si dhe analizën , sqarimet dhe rekomandimi i Autoritetit Kontraktues për aktivitetit të prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 me numër prokurimit KEKC-22-406-521 ka vlerësuar se Operatori ekonomik ne ankesën e tij nuk ka prezantuar prova me të cilën e vërteton faktin se pretendimi i tij eshtë bazuar, dhe te cekurat me lartë paraqet bazë të mjaftueshme për mos ndryshimin e vendimit te marre me date 12.09.2023.
Zyrtari përgjegjës i prokurimit duke marr parasysh dëshmitë te dërguara nga Operatori ekonomik si dhe rekomandimet e lartë cekura ka vendosur si në diapozitivin e këtij vendimi.

Keshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi, Operatori Ekonomik mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së konform dispozitave ligjore te LPP-se nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet :

1x1 ekzemplar – Operatorit Ekonomik
1x1 ekzemplar – Për dosjen e aktivitetit të Prokurimit
1x1 ekzemplar – Arkivës së KEK-ut

u.d. Drejtori i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit

Ymer Dragusha

25/09/2023

2. Njoftim mbi vendimin e AK

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: **Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3**

Nr. i prokurimit	KEK-22-13147-5-2-1
Nr i brendshëm	KEKC-22-406-521

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës me TVSH
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o, Agim Ramadani, Relax OB-N, Hyrja 2-K-2, Nr.A Prishtine, 10000, Prishtine	299.999.99
2.	Flamtron, K.P.Krešimira IV br:1, 44320, Kutina	363.440.00
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, LIDHJA E PEJES 69, -10000, PRISHTINË	344.560.00

Rezultati i aktivitetit te prokurimit: KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. e anulon aktivitetin e prokurimit.

Ne aktivitetit ne prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 dy OE kane autorizimin nga i njëjti OE-FLOWSERVE dhe kane ofertuar si ne vijim Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o me çmim te ofertës 299.999.99 € dhe B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k me çmim te ofertës 344.560.00 €

Gjate fazës se vlerësimit kemi pranuar emalin me datën 23.03.2023 dhe 24.03.2023 nga anëtari i Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë& SARMAT LT , s.r.o, ku pas presionit te bere nga autorizuesi OE-FLOWSERVE për OE SARMAT LT , s.r.o i nijeti është tërhequr nga Aktiviteti i prokurimit Riparimin e pompës furnizuese ne bllokun A3,

Nga komunikimet e pranuara vërehet qartë ndërhyrja e anëtarit te konzorciumit NOVOMAT qe te mos i mundësohet dhënia e kontratës grupit te OE Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë& SARMAT LT , s.r.o.

Bazuar ne komunikimet e pranuara ZPP nuk e kam aprovuar rekomandimin e komisionit te rivlerësimit për shkak te ndikimit ne mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ne ketë aktivitet te prokurimit nga grupi i OE B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT , ku qëllimi i këtij OE ka qene te pranohet oferta tij

Duke u bazuar ne përgjegjësit dhe autorizimet qe parashihen për Zyrtarin përgjegjës te prokurimit ne legjislacionin e prokurimit ne fuqi është marr vendim qe ky Aktivitet i prokurimit te anulohet .

Me respekt,

Zyra Ekzekutive e Prokurimit KEK – sh.a.

12/09/2023

KRITERET PËR VLERËSIM

		Kërkesat e përshtatshmërisë: 1.Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65; 2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit; 3.Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit;	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1.Një deklarata nën Betim, e nënshk tenderuesi duke përdorur formën e p dosjen e tenderit; Dëshmitë lidhur r pranueshmrisë, pika 2, dhe 3 do të k tenderuesi të cilit autoriteti kontraktu mend që t'ia jap kontratën. Këto dok duhet të dorëzohen nga tenderuesi pa së kontratës. Në rast të dështimit të d këtij dokumenti, tenderi në fjalë do t
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale: 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2.Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit; 3.Regjistrimi i numrit fiskal	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.Një dokument i lëshuar nga autorit publik në vendin e themelimit të ope ekonomik me të cilin evidentohet re operatorit ekonomik në atë vend K certifikatës së biznesit); 2.Kopja e certifikatës TVSH-se; 3.Kopja e certifikatës numrit fiskal.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	*Kapaciteti ekonomik dhe financiar:*	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	*Kapaciteti teknik dhe professional:* 1.Autenticiteti i produkteve dhe cilësisë reprezentues 2.Projektet e realizuara për tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate 3.Kualifikimet shkollore dhe profesionale te personelit. -Projekte menaxheri për implementimin e kontrtaes, 4. Mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe ose fotografive dhe vizatime të produkteve që duhet të furnizohen 5. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* 1. Autorizimi nga prodhuesi ose nga autorizuar i prodhuesit bashkangjitur kopja e marrëveshjes r prodhuesin), për modernizim te por furnizim me valvul. 2.Një liste te aktiviteteve të ngjashm specifikon punët e kryera, shumën k datën dhe pranuesin, si dhe duhet te paku 1 (një) referencë apo certifikatë ekzekutimin e punëve të ngjashme n Energjisë elektrike nga punëdhënësi implementimin e suksesshëm te proj vitet e shkuara nga data e publikimit për kontrate, me kontaktet për verif mund të shihet kapaciteti teknik dhe tij. 3. Projekte menaxheri duhet t referenca për punë të ngjashme, duh

			dorëzojë CV, diplomën inxhinier të makinerisë si dhe kontratën e punës 4. Dokumentacioni autentik i prodhu katalogë pjese te katalogut me përsh detale për artikujt që ofertoni. Ne katalog pjese te katalogut sipas specifikimeve teknike te kërkuara te artikujt për pozicionet e kërkuara 5. Kopjet e Certifikatave te prodhu 9001, 14001, ISO 3834-2

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Procedura e hapur
Procedurë e hapur; Vlerë e mesme

Në bazë të nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data kur eshte përgatitur Raporti i Vlerësimit: 30.01.2023

Nr. i prokurimit[1]	KEK-22-13147-5-2-1
Nr i brendshëm	KEKC-22-406-521

Titulli: Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

Kryetar : Mehdi Ejupi — anëtar : Ismail Gashi — anëtar : Hasan Mexhuani

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	KEK-22-13147-5-2-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	KEKC-22-406-521		

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
01.12.2022	12.01.2023, 13:00:00	12.01.2023, 13:00:00	KEK sh.a - rr, Nena Terezë nr. 36, 10000 Prishtinë	3

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dopuna/Izmjena
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o, Agim Ramadani, Relax OB-N, Hyrja 2-K-2, Nr.A Prishtine, 10000, Prishtine	KEK-22-13147-5-2-1	Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3	PO	254.237.28	299.999.99	JO
2.	Flamtron, K.P.Krešimira IV br:1, 44320, Kutina	01/2023	Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3	PO	308.000.00	363.440.00	JO
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, LIDHJA E PEJES 69, - 10000, PRISHTINË	01/23	Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3	PO	292.000.00	344.560.00	JO

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË ADMINISTRATIVE të TENDERËVE

	Kërkesat formale/administrative të përcaktuara në Dosjen e Tenderit										
	Identifikimi i qartë i tenderuesit	Nëse tenderi është dorëzuar nga një grup i operatorëve ekonomik									
	TENDERUESI (Emri, Adresa, Numri fiskal)	Deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Deklaratë e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të njësimarrjes	Deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Formulari i paraqitjes së tenderit i plotësuar dhe i nënshkruar si duhet	Origjinali i tenderit dhe kopje	Sigurimi i tenderit në pajtueshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit	Vlefshmëria e tenderit 60 ditë	Deklaratë e cila deklaron nënkontraktuesin e zgjedhur	Kërkesa të tjera formale/administrative (if	TENDERI I PËRGJEGJSHËM ME KËRKESAT ADMINISTRATIVE PO/JO
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o Agim Ramadani, Relax OB-N, Hyrja 2-K-2, Nr.A Prishtine, Prishtine	Po	Po	Po	Po	N/A	Po	60 ditë	Nuk kërkohet		Po
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k LIDHJA E PEJES 69, PRISHTINË	Po	Po	Po	Po	N/A	Po	60 ditë	Nuk kërkohet		Po
3.	Flamtron K.P.Krešimira IV br:1, Kutina HR57903066772	N/A	N/A	N/A	Po	N/A	Po	60 ditë	Nuk kërkohet		Po

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

Siguria e tenderit

	TENDERUESI	Forma e sigurisë së tenderit	Vlera e sigurisë së tenderit	Sigurimin e tenderit të vlefshëm derime	Emetuesi e sigurisë së tenderit	Informacione të tjera në lidhje me sigurimin e tenderit
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o Agim Ramadani, Relax OB-N, Hyrja 2-K-2, Nr.A Prishtine, Prishtine	Bondi te sigurisë, të lëshuar nga një kompanie sigurimit	12,000.00 EUR	12.04.2023	SIGURIA	
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k LIDHJA E PEJES 69, PRISHTINË	Bondi te sigurisë, të lëshuar nga një kompanie sigurimit	12,000.00 EUR	11.04.2023	Eurosig	
3.	Flamtron K.P.Krešimira IV br:1, Kutina HR57903066772	Garancie të pakushtëzuar bankare	12,000.00 EUR	12.04.2023	Privredna Banka Zgreb	

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E PRANUSHMËRISË

Dokumenti	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o	Flamtron - Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
1.Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65; 2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit; 3.Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit;	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë e pranushmërisë:

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRISË PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokumenti	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o	Flamtron - Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k
	Ne pajtim / Nuk është ne pajtim	Ne pajtim / Nuk është ne pajtim	Ne pajtim / Nuk është ne pajtim
1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2.Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit; 3.Regjistrimi i numrit fiskal	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë profesionale:

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR GJENDJEN EKONOMIKE & FINANCIARE

N/A

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare:

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E AFTËSIVE PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokumenti	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o	Flamtron - Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k
	Në pajtim / Nuk eshtë në pajtim	Në pajtim / Nuk eshtë në pajtim	Në pajtim / Nuk eshtë në pajtim
1.Autenticiteti i produkteve dhe cilësisë reprezentues 2.Projektet e realizuara për tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate 3.Kualifikimet shkollore dhe profesionale te personelit. - Projekte menaxheri për implementimin e kontrtaes, 4. Mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe ose fotografive dhe vizatime të produkteve që duhet të furnizohen 5. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet	I papajtueshëm	I papajtueshëm	Në pajtim

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

Ofertuesit i plotësojnë kërkesat e dosjes se tenderit lidhur me përshtatshmërinë profesionale

Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:

Ofertuesi që i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit lidhur me përshtatshmërinë teknike

Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k

Ofertuesit që nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes se tenderit lidhur me përshtatshmërinë teknike

Flamtron – nuk është i përgjegjshëm, nuk e ka dorëzuar ne oferte planin ideor siç është kërkuar në përgjigjet ndaj pyetjeve sqaruese ku është kërkuar që çdo operator ekonomik është i obliguar që me rastin e dorëzimit të ofertave të prezantoj edhe vizatimet e planit ideor (skicën e sistemit gypor) me të gjitha elementet përcjellëse të sistemit për puthitje dhe ftohje si dhe sistemit të vajit lubrifikues.

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o Nuk eshte i pergjegjeshm sepse antari i konzerciumit eshte terhjekur

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES

Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te lire

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës ekonomikisht më i favorshëm".

Radhë	Lënda / grupi: Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k,	344,560.00

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k	-10000	LIDHJA E PEJES 69

DEKLARATË

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimi te ofertave konkurruese për aktivitetin e prokurimit: DEMONTIMI, MODERNIZIMI DHE INSTALIMI I POMPËS FURNIZUESE NE BLLOKUN A3 me numër. te prokurimit. KEKC-22-406-521, ka ardhur ne përfundim se ofertuesi Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe si e tillë është oferta qe ka ofruar çmimin me te lire të përgjegjshëm ne vlere prej 344,560.00 me TVSH.

Tenderi është udhëhequr duke respektuar dispozitat e LPP-së Nr. 04/L-042 Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullores për Prokurimit Publik, Udhëzues operativ për prokurimin publik).

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE

Në procesverbal, komisioni vlerësues duhet të jep informacione në detaje lidhur me përmbajtjen e secilit tender duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative:

1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o	
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k	
3.	Flamtron HR57903066772	

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

Analiza e çmimit

	TENDERUESI	Informata në lidhje me gabimet ne llogaritje	Arsyet për refuzimin e tenderit për shkak të çmimit anormalisht të ulët
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o		
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k		
3.	Flamtron HR57903066772		

Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit

	TENDERUESI	Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o	
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k	
3.	Flamtron HR57903066772	

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimi te ofertave konkurruese për aktivitetin e prokurimit: DEMONTIMI, MODERNIZIMI DHE INSTALIMI I POMPËS FURNIZUESE NE BLLOKUN A3 me numër. te prokurimit. KEKC-22-406-521, ka ardhur ne përfundim se ofertuesi Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe si e tillë është oferta qe ka ofruar çmimin me te lire të përgjegjshëm ne vlere prej 344,560.00 me TVSH.

Tenderi është udhëhequr duke respektuar dispozitat e LPP-së Nr. 04/L-042 Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullores për Prokurimit Publik, Udhëzues operativ për prokurimin publik).

DËSHMITË LIDHUR ME KËRKESAT E PRANUESHMËRISË[2]

Emri i Tenderuesit te cilit Autoriteti Kontraktues ka ndërmend ndër mend që t'ia jap kontratën	Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë PO/JO			Është shpërblyer me kontrate PO/JO
	Certifikata nga Administrata Tatimore	Certifikata nga autoriteti kompetent gjyqësor apo administrativ	Kërkesa të tjera te pranushmërisë *(të specifikuara)*	
1. Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT				

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit: _____

Nënshkrimi: _____
Data: _____

[2] Të kërkohet vetëm nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën.

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimi te ofertave konkurruese për aktivitetin e prokurimit: DEMONTIMI, MODERNIZIMI DHE INSTALIMI I POMPËS FURNIZUESE NE BLLOKUN A3 me numër. te prokurimit. KEKC-22-406-521, ka ardhur ne përfundim se ofertuesi Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe si e tillë është oferta qe ka ofruar çmimin me te lire të përgjegjshëm ne vlere prej 344,560.00 me TVSH.

Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit	**Nënshkrimi**	
MEHDI EJUPI		31.07.2023
ISMAIL GASHI		31.07.2023
HASAN MEXHUANI		01.08.2023

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

Vërejtje përmbyllëse të Menagjerit DPSH lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:
Nuk pajtohem me propozimin nga komisioni i vlerësimit duke

u.d. Menagjere e Departamentit për punë dhe shërbime në KEK sha:
Emri dhe Mbiemri: Mirvete Gërguri
Nënshkrimi:
Data: 01.09.2023

marrë parasysh emailin e datës 28.03.23 nga përfaqësuesi i Sarramat. Me këtë rast është shkelur Kodi i Etikës Prokurimit neni 7.: dhe kemi një ofertë me çmim më të lartë 44,560.01€.

Vërejtje përmbyllëse të Drejtorit të Prokurimit lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:
Duke u bazuar në emailin datë 23.03.2023 dhe 24/03/2023

u.d. Drejtori i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit në KEK sha:
Emri dhe Mbiemri: Ymer Dragusha
Nënshkrimi:
Data: 04/09/2023

Kemi shkelur e Kodit te etikës 7.2 dhe me këtë shkelje nuk do te bëjmë publikim e OE qe ka mbetur do ti kemi çmimin me te lartë 44.560,01 € apo 15%

Kryetar : Mehdi Ejupi anëtar : Ismail Gashi anëtar : Hasan Mexhuani

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues eshte pale me interes sipas nenit 4.1.26

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0166

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi - Anëtare, Agon Ramadani - Anëtar, Vjosa Gradinaj - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) B & D ENGINEERING SH.P.K., kundër B58 - Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3" me numër të prokurimit KEK-22-13147-5-2-1, me 15/05/2023, mori:

Vendim

1.Aprovohet si pjesërisht e bazuar, ankesa e OE B&D ENGINEERING SH.P.K. ushtruar në OSHP me 27.03.2023 (Protokolli 2023/0166), kurse Anulohet vendimi i AK për dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "*Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3*" me numër të prokurimit KEK-22-13147-5-2-1, i publikuar me njoftimin e datës 06.03.2023, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim.**

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me rivlerësimin e këtij aktiviteti të prokurimit, në të kundërtën OSHP është e detyruar të ndërmarrë masa për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e OE B&D ENGINEERING SH.P.K.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **B & D ENGINEERING SH.P.K.**

Sqarim hyrës - Fillimisht sqarojmë se OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 23.08.2023 me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 11.09.2023 ka njoftuar OE ankues se Kërkesa për Rishqyrtim nuk ka bazë ligjore në këtë fazë, rrjedhimisht i ka shqyrtuar pretendimet ankimore . Eksperti Shqyrtues trajton pretendimet që lidhen me me veprimet e AK-së në raport me dispozitat e LPP-së, duke mos u lëshuar kështu në trajtimin dhe sqarimin e pretendimeve për shkeljen e dispozitave si dhe rrethanat faktike që supozohet kenë ndodhur jashtë fushëveprimit të dispozitave të LPP-së.

Me datën: 04.10.2023, OE "B & D ENGINEERING SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0759, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompes furnizuese ne bllokun A3" me nr. të prokurimit: "KEK-22-13147-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 400,000.00 €. Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP nga OE "B & D ENGINEERING SH.P.K."- Prishtinë,.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Pretendimi 1. AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së me rastin e nxjerrjes së vendimit për anulimin e këtij tenderi dhe veçanërisht me arsyetimin e përdorur për anulimin e tij. Arsye pse mendojmë se AK e ka bërë këtë shkelje është sepse ka vepruar në kundërshtim të plotë me paragrafin 2 dhe 3 të LPP-së duke u sjellur në mënyrë shumë diskriminuese dhe shumë jo profesionale si dhe duke tejkaluar plotësisht kompetencat që i posedojnë me ligjin e prokurimit publik. Veprimi që AK e ka ndërmarr dhe arsyetimi që AK e ka dhënë kur ka vendosur ta anuloj këtë procedurë të prokurimit nuk është në përputhje me asnjërën nga dispozitat ligjore të përcaktuara me LPP për mundësin e anulimit të tenderit dhe për mundësin e trajtimit të çështjes ashtu siç e ka bërë AK. Përpos që nuk ka luajtur rol aktiv në shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë efikase dhe transparente, ka bërë tejkalim të komplet kompetencave të veta duke e luajtur rolin e avokatit të kompanisë nga e cila si duket ka interesa të ngushta materiale. Këtë më së miri e dëshmon fakti që Komisioni i Vlerësimit në mënyrë unanime e ka dhënë rekomandimin që ne të shpërblehemi me kontratë ndërsa Menaxheri i Departamentit për Punë e Shërbime dhe Drejtori i Prokurimit nuk e përkrahin këtë vendim të komisionit por në kundërshtim të plotë me LPP-në dhe me mundësit ligjore që ua jep ky ligj, e anulojnë tenderin duke konstatuar për gjoja shkelje të Kodit të Etikës. Si duket këta zyrtarë nuk ja kanë fare idenë se kur dhe ku duhet të aplikohet kodi i etikës andaj për qëllim të qartësimit të kësaj po e paraqesim mandatin e Kodit të Etikës në të cilin thirren zyrtarët në fjalë:

KODI ETIK I PROKURIMIT

Konform nenit 91.2 të Ligjit Nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 , Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik harton dhe nxjerr Kodin Etik, i cili duhet të respektohet nga të gjithë nëpunësit publik, shërbyesit civil dhe personat e tjerë të punësuar nga autoritetet kontraktuese.

"Kodi etik i prokurimit", i përket **Pjesës D** të rregullave të prokurimit publik. Përmban tre anekse të formularëve standard, si: **"Deklarata nën betim për Zyrtarët e Prokurimit", "Deklarata nën betim për anëtarët e komisionit për vlerësimin e tenderëve" dhe "Deklarata nën betim për punonjësit e KRPP-së, AQP-së dhe OSHP-së".**

Nga kjo po shihet hapur se ky kod i etikës nuk ka fare të bëjë me OE dhe me komunikimet mes tyre por pikërisht ka të bëjë me zyrtarë dhe të punësuar të AK-së dhe së nga ajo që thuhet në këtë kod, del që shkelësit e vetëm të këtij kodi janë pikërisht Menaxheri i DPSH-së dhe Drejtori i Prokurimit. Këta dy të fundit shihet se kanë bërë tejkalim të kompetencave sepse konstatimin për shkelje apo jo të kodit të etikës nuk ka të drejt ta jep AK por është një institucion tjetër që e ka këtë përgjegjësi. Shto këtu faktin se edhe OSHP i ka pasur në trajtim të gjitha këta e- maila në të cilët thirren këta dy zyrtar dhe shumë qartë e ka dhënë vendimin e vet duke e sqaruar komplet situatën. Tani veprimi i këtyre dy zyrtarëve përpos që konsiderohet tejkalim i kompetencave, konsiderohet edhe mos respektim i vendimit të OSHP si institucioni më i lartë i prokurimit që vendos për shkeljet në procedurë dhe jep urdhrat për kthim të gjendjes në parametra normal. Nisur nga krejt kjo po shihet se AK përkatësisht këta dy zyrtar të lartë të AK-së e kanë marrë në dorë edhe rolin e gjykatësit sepse me vërejtjen që e kanë konstatua në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së kanë thënë se gjoja ka pasur ndikim të drejtpërdrejt apo të tërthortë nga ana e Grupit" të OE "B&D Engineering SHPK & NOVAMAT" tek OE Sarmat LT s.r.o.. Lidhur me këtë AK ka konstatua gjithashtu se gjoja është shkelur Kodi i Etikës, por realisht janë pikërisht këta dy zyrtar që po e shkelin Kodin e Etikës me sjelljet e veta që hapur po dëshmojnë se kanë interesa nga OE që po e mbrojnë dhe njëherit po veprojnë jashtë kompetencave ligjore të përcaktuara për pozitat që ata mbajnë në AK. Veprimi i tillë konsiderohet shkelje e plotë e nenit 1 të LPP-së si dhe shkelje edhe e nenit 24 të LPP-së pikërisht nga Drejtori i Prokurimit prandaj kërkojmë nga OSHP që pas trajtimit të lëndës të merr masa ndëshkuese ndaj AK-së dhe drejtorit të Prokurimit. E-mailat që AK i konsideron ndikues i keni si të bashkangjitur kësaj kërkese.

Pretendimi 2. AK përkatësisht Menaxheri i DPSH-së dhe Drejtori i Prokurimit kanë shkelur nenin 7 të LPP-së me rastin e nxjerrjes së Njoftimit mbi Vendimin e AK-së sepse shihet hapur që janë duke vepruar në mënyrë diskriminuese ndaj neve dhe në të njëjtën kohë janë duke e përkrahur dhe favorizuar pa rezervë OE Sarmat LT s.r.o.. Bazuar në paragrafin 2 të këtij neni shihet se AK përkatësisht këta dy zyrtar kanë vepruar në kundërshtim të plotë me kërkesat e këtij paragrafi. Me sjelljen e tyre duke tejkaluar kompetencat e veta, duke luajtur rolin e gjykatësit, dhe duke u sjellur në mënyrë të papërgjegjshme sikur të ishin avokat të kompanisë Sarmat LT s.r.o., kanë nxjerrë një vendim për anulim të aktivitetit me arsyetimin e ndërhyrjeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta nga Grupi i OE "B&D Engineering SHPK & NOVAMAT tek OE Sarmat LT s.r.o., arsyetim i cili nuk përputhet me asnjërën nga mundësit e ofruar nga LPP dhe RRPP-001/2022. Po që se AK apo edhe OE Sarmat Lt s.r.o. ka pasur dyshime apo mendime se ka pasur ndërhyrje dhe presion në këtë çështje, atëherë janë instancat tjera që duhet paraqitur rastin e jo të marrin drejtësinë në dorë dhe të gjykojnë thua se janë gjykatës. Konstatimi i AK-së përpos që është joprofesional, jo ligjor dhe jo real, është edhe tendencioz dhe injorues për faktin se bëhet nga persona jo kompetent dhe në kundërshtim me përshkimin e detyrave të punës që kanë. Krejt kjo sjellje e këtyre dy personave e ka pru AK-në para një

veprimi antiligjor ku hapur shihet favorizimi i OE Sarmat LT s.r.o. dhe në të njëjtën kohë shihet diskriminimi i Grupit të OE "B&D Engineering SHPK & NOVAMAT" si i vetmi tenderues i përgjegjshëm nga të gjithë konkurrentët prandaj konsiderohet me të drejt se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së.

<u>Pretendimi 3</u>. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Edhe pse Komisioni i Vlerësimit me rastin e rivlerësimit kishte vepruar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit, me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat edhe të vendimit të OSHP-së, shihet se janë dy zyrtar nga AK dhe atë Menaxheri i DPSH-së si dhe Drejtori i Prokurimit të cilët nuk e aprovojnë raportin e komisionit vlerësues që në kundërshtim me mundësitë ligjore e procedurale, e anulojnë aktivitetin e prokurimit. Ja si duket konstatimi i komisionit të vlerësimit: dhe i atyre që nuk e pranojnë mendimin e tyre:

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimi te ofertave konkurruese për aktivitetin e prokurimit: DEMONTIMI, MODERNIZIMI DHE INSTALIMI I POMPËS FURNIZUESE NE BLLOKUN A3 me numër. te prokurimit. KEKC-22-406-521, ka ardhur ne përfundim se ofertuesi Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe si e tillë është oferta qe ka ofruar çmimin me te lire të përgjegjshëm ne vlere prej 344,560.00 me TVSH.

Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit	Nënshkrimi	
MEHDI EJUPI		31.07.2023
ISMAIL GASHI		31.07.2023
HASAN MËXHUANI		01.08.2023

Ja si duket konstatimi i atyre që nuk e pranojnë mendimin e komisionit të vlerësimit:

Vërejtje përmbyllëse të Menagjerit DPSH lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:

Nuk pajtohem me propozimin nga komisioni i vlerësimit duke marrë parasysh emailin e datës 28.03.23 nga përfaqësuesi i Sanamat. Me këtë rast është shkelur Kodi i Etikës Prokurimit neni 7.1 dhe kemi një ofertë me çmim më të lartë 44,560.01€.

u.d. Menagjere e Departamentit për punë dhe shërbime në KEK sha:
Emri dhe Mbiemri: Mirvete Gërguri
Nënshkrimi:
Data: 01.09.2023

Vërejtje përmbyllëse të Drejtorit të Prokurimit lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në emailin datë 23.03.2023 dhe 24/03/2023 kemi shkelur Kodit te etikës 7.2 dhe me këtë shkelje nëse do te bëjmë publikim e OE qe ka ndryshuar do te kemi çmimin me te larte 44.560,01 € dyo 15%

u.d. Drejtori i Zyrës Ekzekutive te Prokurimit në KEK sha:
Emri dhe Mbiemri: Ymer Dragusha
Nënshkrimi:
Data: 04/09/2023

Dhe ja si duket arsyetimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit:

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: **Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3**

Nr. i prokurimit	KEK-22-13147-5-2-1
Nr i brendshëm	KEKC-22-406-521

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës me TVSH
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o, Agim Ramadani, Relax OB-N, Hyrja 2-K-2, Nr.A Prishtine, 10000, Prishtine	299.999.99
2.	Flamtron, K.P.Krešimira IV br:1, 44320, Kutina	363.440.00
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, LIDHJA E PEJES 69, -10000, PRISHTINË	344.560.00

Rezultati i aktivitetit te prokurimit: KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. e anulon aktivitetin e prokurimit.
Ne aktivitetit ne prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 dy OE kane autorizimin nga i njëjti OE-FLOWSERVE dhe kane ofertuar si ne vijim
Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o me çmim te ofertës 299.999.99 € dhe
B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k me çmim te ofertës 344.560.00 €
Gjate fazës se vlerësimit kemi pranuar emalin me datën 23.03.2023 dhe 24.03.2023 nga anëtari i Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë& SARMAT LT , s.r.o, ku pas presionit te bere nga autorizuesi OE-FLOWSERVE për OE SARMAT LT , s.r.o i nijeti është tërhequr nga Aktiviteti i prokurimit Riparimin e pompës furnizuese ne bllokun A3,
Nga komunikimet e pranuara vërehet qartë ndërhyrja e anëtarit te konzorciumit NOVOMAT qe te mos i mundësohet dhënia e kontratës grupit te OE Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë& SARMAT LT , s.r.o.
Bazuar ne komunikimet e pranuara ZPP nuk e kam aprovuar rekomandimin e komisionit te rivlerësimit për shkak te ndikimit ne mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ne ketë aktivitet te prokurimit nga grupi i OE B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT , ku qëllimi i këtij OE ka qene te pranohet oferta tij
Duke u bazuar ne përgjegjësit dhe autorizimet qe parashihen për Zyrtarin përgjegjës te prokurimit ne legjislacionin e prokurimit ne fuqi është marr vendim qe ky Aktivitet i prokurimit te anulohet .

Me respekt,

Zyra Ekzekutive e Prokurimit KEK – sh.a.

12/09/2023

E gjithë kjo sjellje e Menaxherit të DPSH-së dhe Drejtorit të Prokurimit nuk ka fare të bëjë me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në kuadër të pozitave që mbajnë. Fillimisht ata thirren gabimisht në Kodin e Etikës i cili nuk e ka fare mandatin të trajtoj çështjen të cilën AK e përdor si shkas për ta anuluar aktivitetin e prokurimit. Së dyti, arsyetimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk përkon me asnjërën nga dispozitat ligjore që flasin për vlerësimin e tenderëve dhe as atyre për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Dispozitat ligjore dhe detyrat e zyrtarëve në fjalë janë të merren vetëm me atë se a ka vlersuar komisioni i vlerësimit konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe konform kërkesave ligjore e jo të merren me atë se kush kujt i ka shkruar e-mail. Çështjen e përgjegjshmërisë e ka trajtuar

shumë saktë OSHP me vendimin e datës 15.05.2023 andaj nuk kemi se pse të merremi më shumë me këtë çështje. OE Sarmat LT s.r.o. bashkë me anëtarin tjetër të grupit ishin të papërgjegjshëm sepse nuk posedonin autorizimin adekuat nga prodhuesi. Ata kishin paraqitur një autorizim jo të saktë duke tentuar ta vënë në lajthitje AK-në (që si duket ja kanë dal) por pas reagimit tonë, u zbulua se ata nuk kanë autorizim valid dhe si të tillë është dashur vet AK të i konsideroj me kohë si të papërgjegjshëm.

Pavarësisht kësaj ndërhyrja e OSHP-së dhe sjellja e drejtësisë në vend duke e aprovuar ankesën tonë si të bazuar ishte mëse e mjaftueshme për AK-në që ta mbyllë aktivitetin e prokurimit me shpalljen fitues të Grupit të OE "B&D Engineering SHPK & NOVAMAT". AK nuk e respektoi vendimin e OSHP-së dhe pa asnjë bazë ligjore u thirr në detaje që janë jashtë kompetencave të sajë. Përpos kësaj, AK aplikoi edhe dispozita e kode që nuk e mbulojnë fare fushën e tillë. AK realisht nuk ka pasur të drejtë fare të veproj kështu sepse sipas komunikimeve po kuptohet se këtu kemi të bëjmë edhe me një konflikt të interesit që janë të përfshirë disa zyrtarë të AK-së.

Për korrektësi duam të sqarojmë se sipas letrës së Sarmat Lt s.r.o. kuptohet se AK ishte në vizitë tek ky OE para se të shpallej ky tender andaj kjo duket paksa edhe e orkestruar nga ane e AK-së dhe e këtij grupi të OE. Vet fakti që disa zyrtar të AK-së po tentojnë me çdo kusht që ta shpërblejnë me kontratë këtë Grup të OE madje edhe duke shkelur ligje e duke vepruar në kundërshtim me kompetencat e veta, tregon se këta të fundit dyshohen se kanë ndonjë interes personal nga grupi i OE në fjalë. Konstatimi i AK se gjoja kemi ndërhyrë apo bërë presion ndaj OE Sarlmat LT s.r.o., në bazë të komunikimeve që i keni në attach nuk mundet të vërehet askund se ka ndodhur diçka e tillë.

Arsyeja pse i kemi mbrojtur interesat e kompanisë tonë si kompania e vetme e autorizuar nga prodhuesi FLOWSERVE, nuk nënkupton presion por mbrojtje e drejtë dhe e ligjshme e interesave tona. Po të sillej AK si duhet këtë çështje që e ka sqaruar shumë mirë OSHP dhe ku decidivisht e ka konstatua se OE Sarmat LT.s.r.o. nuk ka autorizim valid për këtë tender, do duhej ta mbyllte me kohë duke na shpallur neve fitues. Edhe arsyetimi tjetër se gjoja çmimi jonë është më i lartë nuk përkon fare me nenin 59 të LPP-së e as me kriterin e vlerësimit të tenderëve të përcaktuar na vet AK. Vet fakti që OE fillimisht duhet plotësuar të gjitha kushtet për tu cilësuar të përgjegjshëm e mandej të krahasohen çmimet, tregon se OE Sarmat LT s.r.o. bashkë me grupin nuk ishin të përgjegjshëm andaj arsyetimi i AK-së për çmimin aq sa është jo profesional, është edhe naiv.

Kompanitë jo profesionale që nuk posedojnë aftësitë teknik e profesionale të duhur është e ditur që ofertojnë me çmime të ulëta po ja që kushtet ligjore dhe kriteret e dosjes së tenderit e përcaktojnë rregullin e të qenurit edhe i përgjegjshëm përpos posedimit të çmimit më të ulët. Nisur nga kjo del që Grupi i vetëm i OE që ishte i përgjegjshëm në këtë tender jemi ne, andaj AK është dashur dhe duhet të na shpallte neve si fitues. Për korrektësi dhe me të vetmin qëllim sqarimin e këtij kontesti të pa arsyeshëm, po e pasqyrojmë deklarimin e prodhuesit FLOWSERVE lidhur me autorizimin, po e pasqyrojmë atë që ka konstatua OSHP si dhe letrën që ne i kemi shkruar OE Sarmat LT s.r.o. Këtë po e bëjmë me të vetmin qëllim që të konstatohet se është vet AK që është dashur ta eliminoj me kohë këtë OE si dhe të shihet se nuk ka asnjë presion dhe ndërhyrje që ta ketë dëmtuar procesin. OE në fjalë, edhe po të përsëritet ky aktivitet i prokurimit, nuk ka mundësi teknike e dokumentare ta fitoj si projekt sepse teknikisht nuk mundet me realizuar projektin e tillë pasi që i mungon autorizimi i prodhuesit të artikujve që do të riparohen. Ja si duket deklarata e FLOWSERVE:

FLOWSERVE

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.
Rr. Nënë Tereza, 36
Prishtinë
10 000

Brussels March 10, 2023

Reference: Procurement Number: **KEK-22-13147-5-2-1**
Internal Number: **KEKC-22-406-521**
Title: "Dismantling, Modernization and Installation of Feeding Pump in block A3"
"Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3"

To attention of: Mr. Nagip Krasniqi, Mr. Ymer Dragusha, Mr. Emin Tmava, Mrs. Mirvete Gerguri

Dear Mr. Nagip Krasniqi,
Dear Lady and Gentlemen,

With reference to the above-mentioned tender, we would like to let you know following information:

1- Flowserve has appointed 1 distributor for your account, namely the company **Novamat sh.p.k**, located in: Rruga "Ismail Qemali", Pallati Samos Tower, Kati i 8të, Nr. 41, Tirana, ALBANIA, and we authorized this distributor to participate in our name to the above-mentioned tender, only.

2-The company **Novamat sh.p.k** has a valid distributor agreement covering the products of the above mentioned tender.

3-Flowserve does NOT authorize the company Sarmat LT s.r.o. to participate in the name of Flowserve, nor using any Flowserve logo, letter or certificates, in tenders outside of their agreed territory (Slovakia)

4-The certificate (memorandum), a Flowserve salesperson issued on Friday January 4, 2010, has no validity and needs to be seen as void

Flowserve and his official local distributor Novamat are ready to clarify the situation in case needed.

Please feel free to reach out to me,

Best regards

Jos Wilmaerts
Director Distribution Sales EMA
Jwilmaerts@Flowserve.com
Mobile +32 473 925 610

Pra nga kjo po shihet se AK është dashur me kohë ta eliminoj nga konkurrenca këtë OE dhe se i njëjti nuk ka asnjë mundësi teknike të realizoj projektin e tillë. E themi këtë sepse riparimi do bëhet në punëtoritë e FLOWSERVE dhe të drejtën për ta dërguar pompën dhe materialet tjera tek FLOWSERVE e kemi ekskluzivisht vetëm ne. Ja si duket konstatimi i OSHP-së për çështjen e autorizimit që ka parapri krejt këtij kontesti:

Po ashtu Eksperti Shqyrtues përmes raportit të ekspertizës sqaron se Kompania SARMAT ka një memorandum me Flowserve që daton në vitin 2010 për pompa të tjera dhe atë vetëm për territorin e Sllovakisë por jo për modelin e pompës e cila kërkohet në këtë proces të prokurimit e që e prodhon HALBERG. Me që tek ky memorandum nuk ekziston lloji i pompës që tani ky grup i OE e ka ofertuar, njoftojmë se FLOWSERVE e ka marr në zotësi prodhuesin HALBERG në vitin 2015, që tregon edhe më shumë se memorandumi i tillë nuk ka asnjë vlerë reale për tu pranuar nga AK si i rregullt (dëshmia për kohën e kalimit të HALBERG në pronësi të FLOWSERVE gjendet tek ëeb faqja www.halberg.com/cms/index.php?id=1570 Me dorëzimin e një dokumenti të pavlefshëm, ligjërisht të pa lejuar për aplikim në territorin ku zhvillohet procedura tenderike, ky grup i OE është i papërgjegjshëm dhe si i tillë nuk do duhej kurrsesi të kualifikohej si një ofertues i përgjegjshëm prandaj AK ka tejkaluar kompetencat duke mos i marrë për bazë informacionet lidhur me ketë dokument i cili ka ndikuar në kualifikim të OE SARMAT ndërsa ka ndikuar në rezultatin e OE B & D ENGINEERING SH.P.K. për diskualifikim kurse AK ne përgjigjen për Kërkesën për rishqyrtim kishte deklaruar lidhur me shkresën për tërheqjen e autorizimit të prodhuesit FLOWSERVE te kishin pranuar me 11.03.2023 për anëtarin e konsorciumit te grupit të operatorëve ekonomik të shpallur fitues SMART LT s.r.o. duke *pohuar me tej se komisioni i vlerësimit kishte përfunduar vlerësimin dhe i njëjti ishte dërguar për publikim me 06.03.2023 kurse dokumentacioni për prodhuesin atëherë ka qenë valid sepse nuk ka qenë e përkufizuar afati i skadimit po ashtu vet kompania e autorizuar ka qenë pjesë e grupit të formuar për konkurim për këtë aktivitet kurse deklarojnë po ashtu se nuk kishin pranuar ne forme zyrtare ndonjë dokument të till.* Prandaj Paneli Shqyrtues vendosi për ta kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit në fjalë. Meqë Kompania "SARMAT" nuk është distributor i FLOWSERVE dhe nuk ka të drejtë për të autorizuar një palë tjetër në emër të FLOWSERVE pa autorizimin e tyre, atëherë ka bërë përdorimin e pa autorizuar të ISO Certifikatave të prodhuesit FLOWSERVE, le të vërtetohet saktë edhe ky pohim i ankuesit sipas dokumentacioneve të ofruara nga i grupi i të rekomanduarve. Po ashtu AK të vërtetoj faktin nëse të gjith anëtarët e konsorciumit të rekomanduar qëndrojnë prapa marrëveshjes së tyre për të ofertuar në këtë projekt.

Përveç kësaj mund të thuhet se AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat dhe ligjet e prokurimit publik ngase konstatohet se OE "B & D ENGINEERING SH.P.K." ka kontaktuar prodhuesin FLOWSERVE dhe e ka njoftuar me rastin, të cilët kanë reaguar menjëherë përmes përfaqësuesit ligjor të tyre që e mbulon territorin e Evropës. Këta të fundit kanë reaguar duke lëshuar një deklaratë me të cilën e kanë njoftuar edhe KEK-un dhe udhëheqësit kryesor të tyre duke treguar se kompania SARMAT nuk është distributor i prodhimeve të tyre për këtë tender dhe se thirrja në autorizimin e viti 2010 është e jashtë ligjshme. Andaj, Paneli Shqyrtues bazuar në të dhënat e lartcekura vie në përfundimin se në këtë aktivitet të prokurimit AK nuk ka respektuar drejtë dispozitat ligjore dhe vendosi ta kthej në rivlerësim në mënyrë që AK ta bëjë trajtimin e barabartë të gjithë OE, të bëj kontrollimin dhe vlerësimin e dokumentacionit në mënyrë të drejtë, të respektoj kërkesat që vet AK ka vendosur në DT dhe në njoftimin në kontratë

Edhe nga kjo shihet se OSHP i ka pasur në posedim të gjitha komunikimet dhe po të kishte ndonjë presion apo ndërhyrje siç pretendon AK-ja, sigurisht do ta trajtonte si çështje. OSHP shumë qartë e ka konstatua se OE Sarmat LT s.r.o. nuk ka autorizim dhe si i tillë duhet trajtuar sipas dispozitave ligjore dhe kërkesave të dosjes së tenderit. Ja si duket edhe shkresa që ne i kemi dërguar OE Sarmat LT s.r.o.:

Dear Mr. Jos Wilmaerts & Flowserve Team,

Following our correspondence for this tender procedure of KEK, please let us kindly inform you as follows:
- Regarding the complaint letter that we have submitted to KEK, the end user came up with a decision. They have refused our letter.

The reason why this letter has been refused by KEK is the fact that KEK does not accept the response that Flowserve has been submitting to them regarding this matter of "SARMAT Authorization letter". Attached in the word document it is translated in English language the main paragraph of this letter received from KEK for your information.

- As it can be understood from this letter, again we come to the same point that we have been discussing so far: SARMAT has been participating in this tender procedure directly, as part of a consortium. And for this reason KEK can not consider this Authorization letter as not valid, even though it is specifically written in that letter that the territory of Slovakia is the one where Sarmat can apply such a letter, but he has participated directly in the tender!! And this is the second time that a such a deception occurs from Sarmat together with Klaus Union.
-

@ Dear Gentlemen of Sarmat,
As you can probably understand, this entire situation created is unprofessional, uncooperative, but above all it is illegal and strictly forbidden to be applied in business nowadays & forbidden according to FLOWSERVE rules & policy!!

What you have done is not at all correct and your involvement with Klaus Union in this cooperation results completely in contradiction with every, law, every rule and policy of doing business.
What is needed by you is to issue a written statement addressed to KEK through which you inform the final client that the authorization letter submitted by you during the bidding phase is not amenable to this procedure, that it is an invalid and non-applicable document outside Slovakia territory.

Otherwise, from our side, we will have to take all the necessary legal steps, in accordance with the public procurement law; International business laws & Code of Criminal Procedures in the Republic of Kosovo.
Such unprofessional and damaging actions are totally unacceptable and impermissible even for other parties involved in this tendering process, such as our company, which has been operating in the market for so many years, strictly respecting all the rules, laws and obligations arising from them & also at the same time by respecting all the strict rules & company policies of FLOWSERVE.

It is now a proven fact that you, together with Klaus Union, have been cooperating together since July 2022 and you have been preparing this procurement procedure long before the tender was announced in the system, in complete contradiction to the Public Procurement laws.

Dear Gentlemen of Sarmat, through your actions and inactions, you have damaged all the FLOWSERVE group including also all the distributors by taking over your activity in a territory that is not under your responsibility.

At the end we do have one question: Let's assume that your consortium is being awarded with a contract & you will have to implement such a project. The main question is:

Where are you planning to do the modernization of the pump? How have you foreseen this project implementation?

We definitely need to have a feedback from @ SARMAT & from @ FLOWSERVE if possible too!

It is very important that SRAMAT takes all the responsibilities and at the end to react in a professional way and in respect to all of the evolved parties in this unpleasant situation.

Thank you & Best Regards,

on Behalf of Mr. Mehmet KRASNIQI,

Nga krejt kjo letër po shihet hapur se askund dhe në asnjë formë shkrimi i tillë nuk mund të konsiderohet si ndërhyrje apo presion ndaj OE Sarmat LT s.r.o. por vetëm njoftim dhe sqarim, por si duket ky OE nuk e ka kuptuar veprimin e vet që e ka bërë. Këtë e ka sqaruar shumë mirë edhe prodhuesi FLOWSERVE andaj nuk ka asnjë logjikë të merret si presion. Edhe nëse ky OE mendon ashtu, atëherë janë organet e drejtësisë që e trajtojnë këtë çështje e jo AK të merr në rolin e gjykatësit, avokatit, dhe aplikuesit të paligjshëm të ligjeve dhe dispozitave krejtësisht të gabueshme për ta trajtuar çështjen gjoja si shkelje të Kodit Etik.

Nga krejt kjo që u sqarua më sipër po shihet se AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP-së por ka vepruar në kundërshtim të plotë edhe me Kodin e Etikës duke tejkaluar kompetencat e veta, që sipas nenit 414 të KPRK-së konsiderohet edhe vepër penale.

Po ashtu edhe sjellja e OE Sarmat LT s.r.o. që kishte paraqitur dëshmi të rrejshme edhe pse kishte nënshkruar deklaratën nën betim, konsiderohet shkelje e rëndë që sipas nenit 415 të KPRK-së konsiderohet vepër penale. Në këtë rast ne kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të ndërmerr masat disiplinore të përcaktuara me ligj ndaj atyre që kanë vepruar në kundërshtim me LPP-në dhe ndaj atyre që kanë ofruar dëshmi të rrejshme. Krejt kjo që u tha më lartë tregon se AK (përjashto komisionin e vlerësimit) ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së.

Pretendimi 4. AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-001/2022 me rastin e anulimit të tenderit dhe shkelja e tillë vjen si pasojë e mos respektimit të nenit 1, 7 dhe 59 të LPP-së si dhe mos respektimi e vendimit të OSHP-së. Po që se do respektoheshin si duhet kriteret e dosjes së tenderit dhe vlerësimi do bëhej në përputhje me nenet e cekura më lartë, AK do kishte në mesin e tenderuesve një Grup të OE që i plotëson të gjitha kriteret e dosjes së tenderi dhe që posedon edhe çmimin më të ulët në krahasim me të gjithë tenderuesit konkurrues të përgjegjshëm, kështu që nuk do ishte fare e nevojshme për ta anuluar tenderin.

Pas analizimit dhe verifikimit të ofertave të të gjithë OE konkurrent në këtë tender, shihet se të gjithë të tjerët ishin të papërgjegjshëm dhe se tenderi i vetëm që i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga AK dhe që është plotësisht i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, është Grupi i OE "B&D Engineering SHPK & NOVAMAT". Nisur nga kjo lirisht mund të konstatohet se aplikimi i anulimit të tenderit është bërë qëllimisht për të mos na e dhënë neve këtë tender. Arsyetimi i anulimit të tenderit që AK e ka publikuar duket kështu:

Rezultati i aktivitetit te prokurimit: KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. e anulon aktivitetin e prokurimit.
Ne aktivitetit ne prokurimit Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese ne bllokun A3 dy OE kane autorizimin nga i njëjti OE-FLOWSERVE dhe kane ofertuar si ne vijim
Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë; SARMAT LT , s.r.o me çmim te ofertës 299.999.99 € dhe
B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k me çmim te ofertës 344.560.00 €
Gjate fazës se vlerësimit kemi pranuar emalin me datën 23.03.2023 dhe 24.03.2023 nga anëtari i Grup i Operatorëve Ekonomik Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë& SARMAT LT , s.r.o, ku pas presionit te bere nga autorizuesi OE-FLOWSERVE për OE SARMAT LT , s.r.o i nijeti është tërhequr nga Aktiviteti i prokurimit Riparimin e pompës furnizuese ne bllokun A3,
Nga komunikimet e pranuara vërehet qartë ndërhyrja e anëtarit te konzorciumit NOVOMAT qe te mos i mundësohet dhënia e kontratës grupit te OE Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë& SARMAT LT , s.r.o.
Bazuar ne komunikimet e pranuara ZPP nuk e kam aprovuar rekomandimin e komisionit te rivlerësimit për shkak te ndikimit ne mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ne ketë aktivitet te prokurimit nga grupi i OE B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT , ku qëllimi i këtij OE ka qene te pranohet oferta tij
Duke u bazuar ne përgjegjësit dhe autorizimet qe parashihen për Zyrtarin përgjegjës te prokurimit ne legjislacionin e prokurimit ne fuqi është marr vendim qe ky Aktivitet i prokurimit te anulohet .

Ndërsa deklarata e komisionit të vlerësimit, e Menaxherit të DPSH-së dhe Drejtorit të Prokurimit tek procesverbali i vlerësimit duket kështu:

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimi te ofertave konkurruese për aktivitetin e prokurimit: DEMONTIMI, MODERNIZIMI DHE INSTALIMI I POMPËS FURNIZUESE NE BLLOKUN A3 me numër. te prokurimit. KEKC-22-406-521, ka ardhur ne përfundim se ofertuesi Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe si e tillë është oferta qe ka ofruar çmimin me te lire të përgjegjshëm ne vlere prej 344,560.00 me TVSH.

Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit	Nënshkrimi	
MEHDI EJUPI		31.07.2023
ISMAIL GASHI		31.07.2023
HASAN MEXHUANI		01.08.2023

Vërejtje përmbyllëse të Menagjerit DPSH lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:

Nuk pajtohem me propozimin nga komisioni i vlerësimit duke marrë parasysh emailin e datës 28.03.23 nga përfaqësuesi i Samamat. Me këtë rast është shkelur Kodi i Etikës Prokurimit nen 7.1 dhe kemi një oferte me çmim me të lartë 44,560.01€.

u.d. Menagjere e Departamentit për punë dhe shërbime në KEK sha:
Emri dhe Mbiemri: Mirvete Gërguri
Nënshkrimi:
Data: 01.09.2023

Vërejtje përmbyllëse të Drejtorit të Prokurimit lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në emailin datë 23.03.2023 dhe 24/03/2023 kemi shkelur e Kodit te etikës 7.2 dhe me këtë shkelje nëse do te bëjmë publikim e OE qi ka ndodhur do te kemi çmimin me te lartë 44.560,01 € dyo 15%

u.d. Drejtori i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit në KEK sha:
Emri dhe Mbiemri: Ymer Dragusha
Nënshkrimi:
Data: 04/09/2023

Ky arsyetim nuk përputhet me asnjë nga mundësitë që i ofron neni 62 i LPP-së dhe neni 43 i RRPP-001/2022 për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Duhet ceket edhe kjo se asnjeri nga Legjislacioni Primar / as Sekondar që ishte në fuqi kur ka filluar procesi i prokurimit e që duhet aplikohet deri në mbyllje të këtij aktiviteti nuk ofron mundësi të anulimit të tenderit për arsyetimin e tillë. Aq më pak kur dihet se komisioni i vlerësimit e ka dhënë rekomandimin që ne të shpallemi fitues. Arsyetimi nga AK përkatësisht i Menaxherit të DPSH-së dhe Drejtorit të Prokurimit nuk përputhen me asnjërën nga mundësitë ligjore të LPP-së dhe RRPP-001/2022. Ja si duken mundësitë që i ofron LPP dhe RRPP-001/2022 për ndërprerje të aktivitetit të prokurimit pas hapjes publike:

Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

   1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

   2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

Ndërsa sipas RRPP-së përkatësisht nenit 43, mundësitë për anulim duken kështu:

43.5 Procedura e prokurimit *pas hapjes së ofertave* duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i paripaueshëm; ose
k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i paripaueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

43.7 Procedura e prokurimit ***pas hapjes së ofertave* mund** të anulohet për arsyen e mëposhtme:

a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Arsyetimi i AK-së përpos që nuk është i saktë dhe nuk është i vërtetë, është jashtë kompetencave të tijë dhe nuk përputhet me asnjërën nga dispozitat ligjore që e mundësojnë anulimin e aktivitetit të prokurimit pas hapjes publike. Nisur nga kjo nuk kemi se si të mendojmë ndryshe për pos asaj që AK po shkelë qëllimisht nenin 62 të LPP dhe neni 43 të RRPP-001/2022, me të vetmin qëllim që të mos na japë neve kontratën në fjalë. AK ka shkelur edhe nenin 108/A të LPP-së me rastin e shqyrtimit të pretendimeve tona sepse edhe në përgjigjen e dhënë prap shihet se nuk ka vepruar në përputhje me LPP-në. Edhe tek përgjigjja e tillë vërehet tejkalimi i kompetencave nga Drejtori i Prokurimit andaj me të drejt kërkojmë nga OSHP që të merr masa ndaj këtij zyrtari për mos respektim të LPP-së dhe detyrave të veta të përcaktuara me ligj.

Përgjigje në pretendimin 1, 2, 3 dhe 4.

Duke qene se Pretendimet jane po thuajse te lidhura me njera tjetren atehere gjeni pergjigjen e permbledhur per te gjitha pretendimet

Pretendimi se Autoriteti i Prokurimit (AK) ka anuluar tenderin ndaj kjo konsiderohet të ketë shkelur Ligjin e Prokurimit Publik (LPP), dhe ky vendim është kritikuar për mënyrën e përdorur dhe për arsyetimin e dhënë për anulimin e tenderit nga OE ankues.

Këtu kemi te bejme me mos aplikimin e LPP-se dhe tejkalim te kompetencave si:

1. Diskriminim dhe sjellje jo profesionale: OE ankues pretendon me te drejte se ndaj AK-se

për sjelljen e tyre diskriminuese dhe jo profesionale ndaj OE ankues në tender. Bazuar ne LPP-ne *Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik..*

2. Tejkalimi i kompetencave: OE ankues pretendon me te drejte se AK ka tejkaluar kompetencat e tyre ligjore dhe se kanë luajtur një rol që nuk është i tyre, veçanërisht atëherë kur kanë vepruar si mbrojtje ndaj ndërhyrjeve (nëse mund te kete , këto duhet te i trajtojnë organet kompetente e jo AK-ja).

3. Mosrespektimi i procedurave të ligjit: OE ankues pretendon me te drejte se vendimi për anulimin e tenderit dhe arsyetimi për këtë nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara me LPP.

Kjo sugjeron se AK ka ndërmarrë veprime që nuk janë të lejuara ose të rregullta sipas ligjit të prokurimit publik.

Per te anuluar nje aktivitet te prokurimit duhet plotesohen disa kushte si :

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjoduhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Kjo tregon se si ofertuesi ka përmbushur kushtet e një proçedure të prokurimit pa ndonjë shkelje ligjore apo tejkalim të buxhetit të planifikuar. Nëse ofertuesi ka plotësuar kushtet dhe nuk ka ndodhur asnjë shkelje ligjore ose tejkalim i buxhetit, atëherë kjo është një pretendim i bazuar nga ofertuesi (OE ankues).

4. Ndërhyrje në vendim: OE ankues referohet përgjigjes nga AK se komisioni i vlerësimit ka rekomanduar shpërblerjen me kontratë, ndërsa menaxheri i departamentit dhe drejtori i prokurimit e anulojnë tenderin duke i referuar shkeljes së Kodit të Etikës.

Në procedura të prokurimit publik, vendimet për të pranuar ose anuluar tenderin janë përgjegjësi e autoriteteve të prokurimit. Kjo përfshin komisionin e vlerësimit të ofertave dhe zyrtarët e prokurimit. Këto autoritete kanë përgjegjësi dhe kompetenca të caktuara për të kryer vlerësimin e ofertave dhe vendimet e tyre janë të ligjshme në shumicën e rasteve. Në një proces prokurimi, është e rëndësishme që të respektohen rregullat dhe procedurat e rregullta të ligjit të prokurimit publik.

Nëse pas hulumtimit nga organet kompetente inicuar nga OE i cili pretendohet se ka qene nen presion nga OE ankues ne kete ankes, konstatohet se OE ankues ka ushtruar ndikim të padrejtë dhe të papërshtatshëm mbi OE-në që ishte rekomanduar për kontratë, atëherë mund të merren hapa të ligjshëm kundër OE ankues. Ky mund të jetë një kundërshtim i veprimeve të tyre ose një procedurë disiplinore në përputhje me rregulloret e tyre gjithnje nese kjo vertetohet na organet kompetente. Nga analizimi lendes dhe dokumentacionit se paku nga ana ime nuk shof ndonje presion por mbrojtje e te drejtes per vet OE ankues.

Në anën tjetër, nëse AK ka konstatuar se OE ankues ka bërë presion ndaj OE-së që ishte rekomanduar për kontratë dhe ka ndërmarrë veprime për të garantuar që procesi i prokurimit të jetë i drejtë dhe pa ndërhyrje të paligjshme ne kete rast ne cilesine e OE, ata (AK) duhet të i trajtoje te gjithe OE te barabarte referuar nenit *Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi* por siq u cek edhe me lart nuk shifet qe ka presion ne dem te procedures se prokurimit por ne interes te vet mbrojtjes se te drejtes se OE ankues. Kete besoj se mund te konstaton edhe vet Organi Shqyrtues i Prokurimit pasi qe ne vendimin e nxjerre OSHP me 27.03.2023 (Protokolli 2023/0166), nuk ka pare se OE ankues ne kete ankes ka ushtruar ndikim të padrejtë.

Është e rëndësishme që AK të mbrojë integritetin e procesit të prokurimit dhe të sigurojë që vendimet e tyre të jenë në përputhje me ligjin dhe rregulloret.

Mbrojtja e interesave të kompanisë OE ankues në një procedurë të prokurimit është një veprim i ligjshëm dhe i zakonshëm në botën e biznesit. Atehere kur jeni kompania e vetme e autorizuar nga prodhuesi FLOWSERVE për të ofruar produktet e tyre në një tender, keni të drejtën të mbroheni interesat tuaja dhe të përdorni pozicionin tuaj konkurrues në mënyrë ligjore. Është e rëndësishme që të respektohen të gjitha rregullat dhe procedurat e prokurimit publik në këtë proces, dhe kjo përfshin transparencën dhe respektimin e barabartësisë ndërmjet të gjithë ofruesve potencialë.

Ne baze te dokumentacionit dhe raportit te komisionit vleresues keni ofertuar në përputhje me rregullat dhe kushtet e tenderit dhe keni një marrëveshje të autorizuar me prodhuesin FLOWSERVE, ju keni të drejtën të mbani dhe të mbroheni këtë pozicion në mënyrë të ligjshme. Në fund të fundit, është e rëndësishme që të respektohen të gjitha rregullat dhe procedurat ligjore të prokurimit publik për të siguruar një proces të drejtë dhe transparent. Çdo veprim që shkel këto rregulla mund të çojë në pasojat ligjore për personat ose AK-ne.

Në situata të tilla, ndërhyrja e zyrtarëve të tjerë që nuk janë përgjegjës për vendimet e prokurimit ndaj konsiderohen të papërshtatshme dhe të paligjshme. Në raste të tilla, OE ankues ka bazë për të kundërshtuar ndërhyrjen e zyrtarëve të tjerë dhe për të kërkuar që procedura e prokurimit të respektohet dhe të zbatohet në përputhje me ligjin dhe rregulloret e aplikueshme dhe si i tillë pretendimi ankimor **vlerësohet si i bazuar**.

Eksperti shqyrtues ka arritur në një konkluzion se ankesa e OE ankues është e bazuar dhe

kerkon nga paneli shqyrtues te aprovohet **si e bazuar.**

Bazuar në argumentet dhe sqarimet e paraqitura nga OE ankues, dhe duke marrë parasysh që OE ankues ka mbrojtur interesat e tyre të ligjshme si kompania e vetme e autorizuar nga prodhuesi FLOWSERVE si dhe bazuar ne raportin e komisionit vleresues dhe dokumentacionit ne eprokurimi, eksperti shqyrtues rekomandon disa hapa të rëndësishëm:

1. **Ankesa e OE ankuesit të aprovohet:** Eksperti shqyrtues rekomandon që paneli shqyrtues të aprovon ankesen e OE ankues, duke e konsideruar **të bazuar** dhe të rëndësishme për procedurën e prokurimit publik.

2. **Anulimi i njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit:** Panelit shqyrtues i rekomandon që njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të anulohet, pasi që ky veprim duket se është i paligjshëm ose i papërshtatshëm në këtë rast duke mos plotesuar kriteret per nje procedure te perfunduar.

3. **Rivlerësimi i lëndës ose vazhdimi i procedurës së prokurimit:** Panelit shqyrtues i rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim ose të vazhdohet me procedurën e prokurimit, duke u bazuar në raportin e komisionit vlerësues. Ky veprim mund të sigurojë një proces të drejtë dhe transparent për të gjithë ofruesit, përfshirë OE ankues.

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimi te ofertave konkurruese për aktivitetin e prokurimi INSTALIMI I POMPËS FURNIZUESE NE BLLOKUN A3 me numër. te prokurimit. KEKC-22-406- Grup i Operatorëve Ekonomik B & D ENGINEERING SH.P.K.; NOVAMAT sh.p.k, i plotëson të gj tillë është oferta qe ka ofruar çmimin me te lire të përgjegjshëm ne vlere prej 344,560.00 me TVSH.

Tenderi është udhëhequr duke respektuar dispozitat e LPP-së Nr. 04/L-042 Ligji për Prokurimin Publik ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullores për Prokurimit Publik, Udh

Ky është një rekomandim nga eksperti shqyrtues drejtuar panelit shqyrtues ku mund ta marrë në konsideratë për të siguruar që procedura e prokurimit të jetë e drejtë dhe ligjore. Paneli shqyrtues duhet të zhvillojë procedurat e mëtejshme në përputhje me ligjin dhe rregulloret për të trajtuar këtë çështje dhe siguruar një zgjidhje të drejtë dhe të ndershme për të gjithë palët e përfshira.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **B & D ENGINEERING SH.P.K.**

Remzi Llumnica